

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7356 E premte 17 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**K**ëto ditë, ish-ministrja teknike e Arsimit, në një format të gjerë gazetaresk, kritikoi reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar (APU). Në këtë...

Vijon në faqen 20

Nga PËLLUMB KARAMETA

**Kurrikula dhe injoranca e ish-ministres teknike**



Opinion **i** Ditës

**K**am pasur gjithmonë kënaqësinë të futem në një panair librash, pasi më është dukur vetja gjithmonë sikur futem në një festë të madhe dhe sikur...

Vijon në faqen 21

Nga SULEJMAN MATO

**Panairi i përkthimeve dhe disa probleme me letërsinë kombëtare**



Kreu i PD paralajmëron: Dosje e re, do e ndjeni shpejt

## Sherr në Kuvend, Rama: Do vish prapë tek unë, Basha: ka ikur koha jote

Buxheti, Majko kundër partisë: Rritja 10% e pensioneve sa një kofshë pule

Nga VALENTINA MADANI

Parlamenti përmes një seance maratone diskutoi dhe projektbuxhetin e vitit të ardhshëm ku përfaqësuesit e qeverisë e mbrojtën atë si një bazë e re për të bërë shumë më tepër, ndërsa opozita...

Në faqen 2-3

## KESTI I DYTE I DEMSHPERBLIMIT, AFATET PER DOREZIMIN E DOKUMENTEVE

# ISH TE-PERNDJEKURIT, 5 MIJE EMRAT E RINJ

Ministria e Financave publikon listën: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve politikë, dokumentet që duhet t'i dorëzojnë brenda 3 muajve



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 12-14

SI NDODHI NGJARJA

**Masakra e Mamurrasit, 107 vjet për 4 të akuzuarit, dy vëllezër e dy kushërinj**

Në faqen 11

INTERVISTA

**Ermonela Felaj: Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm, si do zgjidhet ngërçi**

Në faqen 4-5

ORGANIZIMI I GRUPIT

**Trafik droge nga Holanda në Itali, në pranga 14 vetë, 6 prej tyre shqiptarë**

Në faqen 10

DASHNOR KALOÇI

**Raporti i Agollit: Për gabime ideologjike u dënuan 80% e kuadrove të gazetës "Drita"**

Në faqen 16-17

ÇFARE NDODHI



**Shkuan në Londër për trajnim, dezertojnë 4 ushtarakë shqiptarë, MB bën denoncim**

Në faqen 6

Flet Suzanna Schutz: Anëtarësimi në BE pa plotësuar kushtet, proces i vështirë

## S'ka azil, ambasadorja: Rrugët për punësim në Gjermani

*"Çështja Tahiri": Imuniteti të mos pengojë punën e drejtësisë*

Nga ORNELA MANJANI

Shqiptarët që shkojnë për azil në Gjermani kanë shanse thuajse zero për të përfituar. Ka një rrugë ligjore përmes së cilës çdo person mund të shkojë në Gjermani e të integrohet atje. Sigurimi

i një kontrate pune dhe marrja e një vize në Ambasadën Gjermane në Tiranë është e vetmja rrugë që duhet të ndjekin shqiptarët që të emigruar në Gjermani. Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Suzanna Schutz, në një intervistë për...

Në faqen 7

**belleair**  
Shpk, Shoqëri në Faliment

Njoftim për shitje nga mbledhja e ofertave publike

Njoftim për shitje me ofertë të drejtëpërdrejtë

## BUXHETI 2018 DEBATI

PD, Tabaku: Paketa fiskale e qeverisë, parashikon vetëm rritje taksash

# Buxheti, Majko: Rritja 10% e pensioneve, sa një kofshë pule

"10% e pagës sonë i thonë një darkë, ndaj duhet riparë"

Valentina Madani

Parlamenti përmes një seance maratonë dis kutoi dje projektbuxhetin e vitit të ardhshëm ku përfaqësuesit e qeverisë e mbrojtën atë si një bazë e re për të bërë shumë më tepër, ndërsa opozita e denoncoi për rritje taksash. Por ndryshe mendon ministri për Diasporën Pandeli Majko sidomos në rastin e rritjes së pensioneve. Ministri i Ramës, duke folur për buxhetin kërkoi rishikimin e tij pasi duhet ndryshim në rritjen e pensioneve. Ai mori një shembull ku krahasuar rritjen që i bëhet rrogës së një politikane dhe rritjes që i bëhet një pensioni. Majko më konkretisht është ndalur në rritjen e pensioneve, madje ka ironizuar kolegët e tij të mazhorancës, për përmendjen e shifrës 10% të rritjes së tyre. "Duke përfutur nga ikja e kolegut tim ministri Ahmetaj, dua të them dy fjalë për buxhetin. Ne, për çdo rritje që bëjmë, flasim me përqindje. Qeveria thotë se u rritën pensionet me 10%. Por 10% e pagës sonë i thonë një darkë, ndërsa 10% e një pensioni është një kofshë pule, për të mos thënë që është vetëm ajo këmba e pulës. Është momenti që të shkëputemi nga teknika e përqindjeve. Pasi 10% është pak i ndryshëm në këndvështrim të ndryshme", deklaroi ministri Majko. Nga ana e saj deputetja e PD, Jorida Tabaku, shprehu bindjen se projektbuxheti i vitit 2018, parashikon vetëm rritje taksash dhe asgjë tjetër. Sipas saj ky është buxheti i krizës së shqiptarëve. "Projektbuxhetin e kemi diskutuar në komisionet parlamentare, dhe i kemi parë në të dyja anët. Ne kemi diskutuar jo vetëm rritjen e pagave dhe pensioneve, por edhe rritjen e taksave. Rrit taksën për bizneset e vogla, mbi 50 mijë



Ministri i diasporës,  
Pandeli Majko



Deputetja e PD,  
Jorida Tabaku

biznese të vogla do të paguajnë 20 për qind, që do të thotë rritje të ushqimeve. Rritje të taksës së pronës, që do të përfitojnë vetëm disa biznese selektive. Nëse kjo rritje taksash galopante do shoqërohej dhe me investime publike apo dhe rritje të pagave dhe pensioneve do të ishte normale, por ky buxhet nuk ka asnjë prioritet.

Qeveria me të vërtetë thotë se kemi një faturë të investime publike, por në këtë faturë 12 miliardë lekë janë koncesionet që qeveria do të duhet ti paguajë, pasi i ka lidhur kontrata", - deklaroi zj. Tabaku. Deputetja demokrate, paralajmëroi se së shpejti do të rritet aksioni opozitar kundër qeverisë. Tabaku theksoi se opozita do të vijojë të jetë në

### JORIDA TABAKU

"Rrit taksën për bizneset e vogla. Buxheti rrit taksën e pronës, që do të përfitojnë vetëm disa biznese selektive. Nëse kjo rritje taksash galopante do shoqërohej dhe me investime publike apo dhe rritje të pagave dhe pensioneve do të ishte normale, por ky buxhet nuk ka asnjë prioritet. PD do jetë në ballë të protestave", -tha Tabaku.

### PANDELI MAJKO

"Qeveria thotë se u rritën pensionet me 10%. Por 10% e pagës sonë i thonë një darkë, ndërsa 10% e një pensioni është një kofshë pule, për të mos thënë që është vetëm ajo këmba e pulës. Është momenti që të shkëputemi nga teknika e përqindjeve. Pasi 10% është pak i ndryshëm në këndvështrim të ndryshme", - deklaroi ministri Majko.

### KLAJDJA GJOSHA

"Është një buxhet, i cili është për të ardhur keq, sepse më shumë e largon Shqipërinë nga Europa, se sa e afron atë. Kur flasim për procesin e integritetit, e dinë të gjithë që buxheti duhet të jetë në të njëjtën linjë me procesin e integritetit. Ku kanë shkuar fondet? Është një buxhet që nuk ofron asgjë, përkundrazi ofron një rritje taksash, po vret shpresën e shtresës së varfër në Shqipëri, por edhe të shtresës së mesme", -tha deputetja e LSI-së.



## Pastrimi i parave, gati grupi i ekspertëve

### Xhafaj: Skedar kombëtar për grupet kriminale

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj paralajmëroi dje të tjera arrestime në Fier pas goditjes të një grupit kriminal që ishte i përfshirë në trafik droge, vrasje dhe rrëmbime. "Goditja e një grupi kriminal në Fier, vetëm dy ditë më parë, një prej 5 grupeve kriminale të skedura në këtë rajon, është vetëm fillimi i këtij procesi, që do të vazhdojë edhe me më intensitet dhe vendosmëri në muajt që vijjnë", - theksoi ministri. Xhafaj foli për krijimin e një skedari kombëtar me të dhënat e të gjitha grupeve kriminale, mbi të cilin do të veprojë operacioni "Forca e Ligjit". "Jemi



pothuajse në përfundim të grumbullimit të të dhënave mbi grupet kriminale veproue në vend. Jemi duke ndërtuar një

database të plotë, që kurrë më parë nuk ka ekzistuar, kaq unike dhe përfshirëse, me të dhëna për personat konkret të përfshirë në këto grupe kriminale, lidhjet e tyre kriminale, aktivitetet e rënda të dyshuara se janë kryer apo mund të kryhen prej tyre, pasuritë që zotërojnë, investimet ekonomike të bëra me të ardhura nga aktiviteti kriminal, zonat e ndikimit, lidhjet me grupet e tjera jashtë vendit apo mbështetjen që kanë siguruar ndër vite për të lehtësuar veprimtarinë e tyre kriminale", deklaroi z. Xhafaj. Sipas ministrit të Brendshëm në betejën me krimin Policia e Shtetit do asistohet edhe nga ekspertë ndërkombëtarë, të cilët do të ndihmojnë në luftën kundër pastrimit të parave.

## Shehi, Ramës: Unë kam pirë verë jo drogë

Kreu i LZHK-së Dashamir Shehi e quajti të turpshme që Edi Rama të dali në podiumin e parlamentit të të flasë për "qepët dhe rakinë", madje kërkoi që deputetët të reagojnë. Shehi gjatë fjalës së tij në Kuvend deklaroi se pi verë, po jo lëndë narkotike. "Jo qepa, jo rakia. Unë kam pirë ndonjë gotë raki, madje lashë një gotë të mirë vere para se të vija në seancë, por drogë ama nuk kam pirë kurrë. Ky është turp i madh dhe turpju qoftë juve që nuk reagoni", -tha Shehi. "Ne kemi një pyll të madh, e ky nuk është me kanabis, por po e quaj pyll i problemeve, këtë duhet të diskutojmë sot në parlament, duhet të diskutojmë buxhetin dhe problemet e qytetarëve", - u shpreh kreu i LZHK-së Dashamir Shehi.

## Patozi-Bashës: Je qesharak si Ventura i Italisë

Ish-deputeti i Partisë Demokratike Astrit Patozi kritikoi dje kreun e opozitës Lulzim Basha, duke e krahasuar atë me trajnerin italian Gianpiero Ventura, i cili nuk arriti të kualifikonte Italinë në Botëror. Në një postim në "Facebook", Patozi shkruan se Basha është qesharak si Ventura, por ndryshe nga Italia, ku atje u mblodhën ca burra dhe e shkarkuan, "Në Tiranë burrat u mblodhën që të shpallnin me unanimitet fitoren e humbësit. "Kur të gjithë prisnin të paktën dorëheqjen e tij, si ngushëllimin më të vogël, Gian Piero Ventura numëronte sukseset, që kishin arritur "gli azzuri" në udhëheqjen e tij. U bë kaq qesharak, sa mund të krahasohej vetëm me Lulzim Bashën në Shqipëri, pas zgjedhjeve të 25 qershorit", -shkruan Patozi.





## SITUATA POLITIKE

### INTERVISTA

Darina Tanushi

Kryetarja e Komisionit parlamentar të Sigurisë, Ermonela Felaj deklaroi në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" se shifrat e kriminalitetit në vend janë më të ulëta, por shqetësues mbetet trafiku. Si ish-prokurore, Felaj shprehet se brenda sistemit të drejtësisë ka njerëz të ndershëm që e duan reformat dhe vetëgung.

**Ju tashmë jeni deputete e Kuvendit, ndërkohë që keni ardhur në politikë si prokurore e më pas edhe ministre. A mund të na veçoni se cila nga këto eksperiencë është më mbresëlënëse?**

Është pak e vështirë të thuash se cilat nga këto eksperiencë të punës është më e mira apo më mbresëlënëse ashtu sikurse ju e thatë në pyetjen tuaj, por sidoqoftë të gjitha eksperiencat e punës janë të vlefshme në gjykimin tim dhe të gjitha kanë qenë shumë impajative sa i takon punës që më është dashur të bëj në secilën prej tyre. Sigurisht që kam nostalgji për kohën kur punoja si prokurore, por Kuvendi i Shqipërisë dhe genia deputete më kanë dhënë mundësinë që të mos shkëputem nga ligji për sa kohë aktiviteti i parlamentit është ligjërja. Dhe në këtë kuptim mua profesioni im i parë, profesioni si juriste më ka ndihmuar që unë të mund të kryej detyrat që më janë besuar dhe më duhet të falënderoj goftë kryeministrin Edi Rama, goftë kryetarin e Kuvendit Gramoz Ruçi dhe kryetarin e grupit Taulant Balla, për detyrën e fundit që më është dhënë për të drejtuar Komisionin e Sigurisë. Unë kam pasur edhe mbështetjen e tyre në çfarë punë përpara të punëve në një komision që është ndoshta më pak i njohur për publikun në aktivitetet e veta, por ka një rol të rëndësishëm në ndjekjen e përgjegjësi të tij.

**A ju duket e vështirë të drejtoni një komision të kësaj rëndësie, ku në shumicën e mbledhjeve flitet për çështje të sigurisë, çështje të sekretit shtetëror? Dyert herë pas here janë edhe të mbyllura edhe për gazetaret.**

Unë jam në mandatin tim të tretë si deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Kam qenë anëtare e Komisionit të Ligjeve edhe anëtare e Komisionit të Sigurisë. Kështu që përpara se të isha kryetare e këtij komisioni e kam njohur punën në këtë komision pikërisht nga pozita e anëtare. Nga ana tjetër, nëse për dikë krijon një lloj kurioziteti të pasurit e

'Siguria' që vjen nga ish-prokuroerja: Shifra më të ulëta të kriminalitetit

# Ermonela Felaj: Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm, si do zgjidhet ngërçi "Tahiri", ta zbardhin organet e drejtësisë"

raporteve me institucione të inteligjencës (disa prej tyre), për anëtarët e këtij komisioni nuk është e tillë. Sigurisht duhet të përmbushen disa kushte nga anëtarët e këtij komisioni për t'u njohur me sekretin shtetëror.

Ndërkohë nuk ka asgjë për t'u bërë kureshtarë se punë është edhe në atë rast, por njohja e publikut me këtë informacion është e ndaluar ose e kufizuar. Dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Sigurisë kanë detyrimin t'i përmbahen këtij detyrimi, të ruajnë atë pjesë të informacionit që përbën sekret. Nga ana tjetër, më duhet ta them jo pa një lloj dhimbjeje se te ne janë mësuar me përhapjen e gjërave që duhet të mbaheshin konfidenciale, duket sikur asgjë nuk përbën më sekret dhe për çdo gjë të konsideruar të tillë, pason pyetja: Pse kjo është sekret?! Në fakt, ka informacione të natyrës së tilla që janë të rezervuara, po



Kryetarja e Komisionit parlamentar të Sigurisë, Ermonela Felaj

jenë të hapura për publikun, pikërisht se duke qenë të tilla të fshehta ato mund të japin atë informacion që nevojitet për të çuar përpara këtë luftë. Kështu që nuk ka asgjë këtu për të vënë në dyshim nëse diçka përbën apo jo sekret. Shpesh herë në Komisionin e Sigurisë na është dashur të përballojmë debate të tipit nëse duhet të jenë të pranishme kamerat/mediat ose jo në mbledhje të komisionit, dhe vendimarrja jonë ka qenë e kushtëzuar nga ajo çfarë në kanë thënë drejtuesit e institucioneve që kanë ardhur për të raportuar, sepse janë ata personat e parë përgjegjës që njohin natyrën e informacionit që duan t'i bëjnë me dije Komisionit të Sigurisë. Përgjithësisht një komision i është përmbajtur kërkesave të tyre. Por ka ndodhur që pasi jemi njohur me informacionet ka pasur edhe konsideratë të tipit "pse kjo ishte sekret?!".

Po, pra ka gjëra që janë sekret dhe që nuk mund të ndahen me publikun, por duhet të përdoren për aq sa është e nevojshme dhe e domosdoshme në komisionin tonë. Në fund të fundit detyra jonë si ligjvënës nuk është të zëvendësojmë këto

institucione. Ato kanë misionin dhe qëllimin e tyre. Detyra jonë është të mund të kuptojmë se çfarë ndodh në këto institucione, të kuptojmë nëse ligji është një instrument i mjaftueshëm, që ato të organizojnë veprimtarinë e tyre apo ligji ka mangësi të tilla, që ne pastaj si ligjvënës na duhet të ndërhyjmë ta përmirësojmë dhe ta bëjmë ligjin atë instrument për të cilin këto institucione kanë nevojë.

**Ju kemi parë këto ditë që keni pasur debate të forta në komision me opozitën, me zotin Noka, për shembull. Ju si gra në drejtimin e këtij komisioni, ku mbizotërojnë burrat, si e keni ndier veten?**

Është një komision që në shumicë përbëhet nga meshkuj. Personalisht nuk është se më bën përshlyetje kjo pjesë, sepse vij nga një lloj përvojë pune ku shumica e njerëzve që punojnë janë meshkuj. Deri vonë, në fakt, në prokurori kanë punuar më shumë meshkuj se sa femra. Megjithatë vitet e fundit realiteti edhe aty ka ndryshuar, sepse falë shkollës së magistraturës është bërë e mundur që aty të vijmë edhe shumë femra prokurore si edhe shumë

femra gjyqtare. Kështu që besoj nuk është më realiteti i viteve 2000, kur unë fillova punën si prokurore, gjërat kanë ndryshuar. Por nuk është kjo ajo që ka tërhequr vëmendjen time, unë nuk nisem nga përbërja gjinore e komisionit në punën time. Ajo që ka rëndësi është se çfarë përfaqësojnë njerëzit në komision, përkatitja e secilit, dëshira dhe vullneti për të bashkëpunuar, aftësia për të ndarë politkën nga puna e përditshme e këtij komisioni, ose më mirë ta them, aftësia për të bashkuar politikën me punën në masën që duhet, këto do të na ndihmonin vërtetë. Ndërkohë pastaj, shfaqjeve të tipit primitiv, unë nuk do të doja t'u rezervoj më shumë koment se sa kaq, sepse nuk janë më të reja, janë të vjetra dhe ndoshta në këtë pikë u takon partive politike që të kujdesen më shumë për njerëzit që ofrojnë në listat e tyre zgjedh-

## PRESIDENTI

**"Nuk mund të ngrihej në asnjë mënyrë një kërkesë e tillë dhe natyrisht është i drejtë edhe qëndrimi i Presidentit të Republikës. Është një qëndrim konform ligjit për informacionin e klasifikuar."**

hor, sepse sjellje të tilla si ajo që ju më përmendët pak më parë nuk është që fyejnë Ermonelën kryetare të këtij komisioni apo anëtare nuk ka rëndësi. Unë besoj që ato



fyejnë publikun që interesin e parë që ka është që njerëzit e zgjedhur të punojnë dhe të realizojnë interesat e tij dhe jo të përdorin vendin e anëtarit të komisionit dhe prezencën e kamerave për të bërë një show që është thjeshtë i neveritshëm. Deri këtu do ta çoja komentin tim, sepse nuk dua të bie në rrjetën që të merrem me sjellje të tilla. Nuk e kam aspak ndërmend. Rregullat e punës janë të normuara qartë në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Kushdo që di të lexojë dhe do të lexojë duhet të jetë në gjendje t'i zbatojë dhe të kuptojë se përse këto rregulla janë vënë. Natyrisht ne aty jemi përfaqësues të forcave të ndryshme politike. Por fakti pse jemi të ndryshëm, pse kemi qasje të ndryshme kjo nuk duhet të na pengojë që të shprehim qëndrimet tona me qytetari e respekt përkundrejt njëri-tjetrit, sepse nuk jemi në sallën e Kuvendit apo komisioneve si armiq, por jemi si kundërshtarë apo si njerëz që ruajnë pozicione të ndryshme për ligjin ose për çështje të tjera që na duhet të diskutojmë.

**Jemi në fazën, kur reforma në drejtësi është në pikun e saj, kanë filluar rezultatet e para dua t'ju pyes: Ju si ish-prokurore a keni ndonjë ndjesi në lidhje me prokurorët e gjyqtarët që presin të kalojnë vetëgung e punës?**

Unë mund t'ju them me shumë siguri, me sigurinë e një njeriu që vjen nga ai organ, me sigurinë e një njeriu që ruan ende lidhje të pastra shoqërore bren-

**EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A."**  
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1- "Ara-Truall" me sipërfaqe 582 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 112.2 m<sup>2</sup>, dhe ndërtesë 112.2 m<sup>2</sup>, Nr. Pasurisë 6/1/241, Zk. 1298, Volum.17, Faqe.87, e ndodhur në Bucimas, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **110.800 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **11.12.2017 ora 16.00** në adresën Rr. "I. Qemali", Pall. "Fratri", K.6, Tiranë.

2- "Truall" me sipërfaqe 3.942 m<sup>2</sup>, Nr. Pasurisë 731/45, Zona Kadastrele: 2648, Volum.7, Faqe.110, e ndodhur në Memelisht, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **59.602 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **11.12.2017 ora 16.00** në adresën Rr. "I. Qemali", Pall. "Fratri", K.6, Tiranë.





← da këtij organi që një shumicë e njerëzish që punojnë në sistem, nuk janë të tillë, të pandershëm. Por janë të dedikuar në profesionin e tyre dhe që natyrisht këto janë edhe pjesa më e pazëshme, por që në rastin e reformës në drejtësi janë pjesa që e duan më shumë. Sepse ka ardhur momenti që të ndodhë ajo që kryeministri e konsideron si pastrimi i pallatit të drejtësisë. Dhe mua më vjen mirë që, pavarësisht nga vonesat që u shkaktoan për ecurinë e reformës në drejtësi, më në fund organet e vetingut janë ngritur, po plotësohen dhe trupat ndihmëse dhe ka filluar edhe vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve të parë. Janë bërë publikë emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të parë që do të kalojnë vetingun. Është shumë e rëndësishme që vetingu të kryhet në kohë dhe të kryhet ashtu siç duhet, sepse nga kryerja e vetingut varet edhe ngjitja e dy institucioneve kryesore për qeverisjen e prokurorisë dhe gjyqtarëve, bëhet fjalë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe pastaj edhe institucione të tjera, siç janë edhe Prokuroria e Gjykata e Posaçme, që do jenë për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe Byroja e Hetimit. Pra, me të drejtë mund ta quajmë procesin e vetingut si "thembra e Akillit" të të gjithë reformës në drejtësi.

Më vjen mirë, po ashtu, që qeveria nga ana e vet u kujdes që të plotësohen maksimalisht kërkesat e komisioneve të vetingut.

**A garantoni që Partia Socialiste dhe qeveria nuk do të ketë ndikim në përzgjedhjen e këtyre trupave?**

Formula e zgjedhur dhe e shprehur qartësisht në ligj përjashton në maksimum ndikimin e partive politike. Sepse përzgjedhjet janë me

shumicë të cilësuar, kështu që është shumë e vështirë të flasësh për përdorim politik të komisioneve të vetingut apo institucioneve që do të krijohen në vijim. Nuk ka ndodhur kjo deri më sot dhe nuk e shoh të ndodhë. Në gjykimin tim ecuria e deritanishme e procesit të vetingut është e mirë dhe këtu kam parasysh faktin që në procesin e vetingut janë të përfshirë edhe disa institucione të tjera: bëhet fjalë për Drejtorinë e Pastrimit të Parave, për Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Shërbimin e Çështjeve të Brendshme që ka Policia e Shtetit dhe Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar. Në 3

## PROKURORËT

"Unë mund t'ju them me shumë siguri, me sigurinë e një njeriu që vjen nga ai organ, me sigurinë e një njeriu që ruan ende lidhje të pastra shoqërore brenda këtij organi, që një shumicë e njerëzish që punojnë në sistem, nuk janë të tillë, të pandershëm."

prej këtyre institucioneve ne si komision kemi qenë, jeni njohur me punën që bëjnë dhe në mënyrë të veçantë jemi njohur lidhur me çfarë ato kanë bërë në kuadër të procesit të vetingut. Që gjatë verës këto institucione kanë punuar me deklarata të dorëzuara për shkak të ligjit të vetingut nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe kanë për-

punuar një numër jo të vogël deklarata. Janë të paktën 3 mijë deklarata me të cilat është marrë secili institucion dhe kjo është një punë paraprake shumë e rëndësishme e kryer tanimë. Nëpërmjet vetingut bëhet e mundur që të kontrollohet figura e çdo gjyqtari dhe çdo prokurori sa i përket lidhjeve të tyre shoqërore, me qëllim identifikimin e lidhjeve që janë të papërshtatshme për t'i pasur një gjyqtar ose një prokuror, kontrollohet pasuria e tyre po ashtu për të identifikuar nëse pasuritë e tyre janë vendosur mbi të ardhura që rrjedhin nga puna apo për burime të tjera jo të ligjshme.

Ndërkohë kontrolli i vendimmarrjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve është po ashtu një aspekt tjetër i vetingut me qëllimin për të parë nëse vendimet janë dhënë konform ligjit apo janë vendimmarrje që parapraken nga lidhje me natyrë të dyshimtë, lidhje korruptive.

**A mund të themi që rezultatet e para kanë filluar që me arrestimin e gjyqtarit Shkëlqim Miri apo pritend?**

Unë e shoh si një lëvizje të mirë brenda sistemit, në kuptimin që ka reagim, por njëkohësisht e shoh edhe si mënyrë për të parandaluar sjellje të natyrës së tillë. Sigurisht gjëja nuk erdhi në kuadër të një pune policore dhe të prokurorisë për të mbledhur ato prova që çuan deri në arrestimin e gjyqtarit në fjalë. Besoj që kjo punë duhet të fuqizohet dhe tanimë që Ministria e Brendshme shpalli krijimin e Task Forcës që do të kryejë edhe operacionin "Forca e ligjit". Qëllimi i Task Forcës që përfshin në vetvete punonjësit të të gjitha këtyre institucioneve që përmendëm është pikërisht që të përqendrojë luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve.

**Po diskutohet çdo ditë çështja e drogës. Kemi pasur edhe deklarata të forta nga ambasadori amerikan Donald Lu për 4 familjet mafioze. Ju si komision, në këtë periudhë kohe kemi pasur informacione, në lidhje me këtë problem gjatë këtyre muajve që ju e drejtoni. Si është situata aktuale?**

Ne në Komisionin e Sigurisë kemi marrë informacione për kriminalitetin nga nivele të ndryshme. Kemi marrë statistika për kriminalitetin nga Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe padysishim kemi marrë edhe nga Ministria e Drejtësisë. Ajo që vërej unë edhe si juriste, edhe si prokuror është fakti që koeficienti i kriminalitetit, të paktën këto vitet e fundit ka ardhur duke u ulur në mënyrë të ndjeshme. Koeficienti i kriminalitetit tregon ndodhshmëritë e veprave penale për 100 mijë banorë. Dhe në këtë rast po të nisesh

nga totali i të dhënave për vepra penale do të vëshesh që ky koeficient ka ardhur duke u ulur... për shembull ne kemi numrin më të ulët të vrasjeve që është shënuar ndonjëherë. Po t'i shikosh si vepra penale vihet re që më e përhapura është vjedhja. Ka një rritje të trafiqet, sigurisht, por kjo nuk zbeh dhe nuk mund të mohohet puna që është bërë, sepse

## ÇËSHTJA "TAHIRI"

"Saimir Tahiri është nën hetim dhe natyrisht i takon prokurorisë dhe gjykatës që të shpallin para publikut të vërtetën për çështjen në fjalë. E vetmja gjë, për të cilën ne nuk ishim dakord me kërkesën e prokurorisë, ishte vendosur masën e arrestit me burg."

veçanërisht verën e këtij viti ka pasur një shtim të jashtëzakonshëm të luftës kundër narkotikëve, gjë e cila u confirmua edhe në raportin e shpallur nga Guardia di Finanza. Shqipëria nuk është më një vend i kultivimit. Kuptohet që problemet e trafikimit nuk janë një problem i ri që ndodhi sot. Janë një problem i hershëm në Shqipëri, janë fenomen në vende të tjera, janë sfida që na duhet t'i përballojmë ne, i përballojnë edhe të tjerët. Ajo që ka ndryshuar është fakti që është kuptuar që këto lloj krimesh nuk mund të luftohen të vetëm. Këto kërkojnë bashkëpunim në nivel ndërkombëtar, sepse trafiki nuk është se bëhet brenda territorit të një vendi. Ato kalojnë nga një territor në një tjetër ose nganjëherë përfshijnë më shumë se sa dy territore. Ndaj është shumë e rëndësishme që puna të jetë e përbashkët mes vendeve e po kështu informacioni të ndahet në kohë reale. Task Forca që u shpall së fundi i reflektim të gjitha këto nevoja, po t'i referohesh mënyrës sesi është konceptuar të funksionojë kjo Task Forcë.

**Meqë jemi duke folur për drogën, një nga çështjet që u bë temë e ditëve të fundit ishin përgjimet e bandës së Habilaive, ku u përmend edhe emri i ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Sigurisht do të jetë gjykatë që do e vendosë, por sa besoni ju në pajfësinë e kolegut tuaj?**

Unë e shoh këtë çështje si çështje të vënit bast. E shoh si një çështje që është detyrim i organeve të drejtësisë për ta zbardhur. Nga ana

tjetër Partia Socialiste, grupi parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me këtë çështje. Saimir Tahiri është nën hetim dhe natyrisht i takon prokurorisë dhe gjykatës që të shpallin para publikut të vërtetën për çështjen në fjalë, e vetmja gjë për të cilën ne nuk ishim dakord me kërkesën e prokurorisë ishte kërkesa për të vendosur masën e arrestit me burg ndaj tij dhe konsiderata jonë për të mos e pranuar këtë çështje lidhet thjeshtë dhe vetëm me faktin që ne nuk mund të lejojmë që precedentet të tillë nuk ngrihen dhe bazohen në prova të mund të bëhen shkas pastaj për t'u përdorur për raste të tjera. Dhe qëllimi që në Kushtetutën tonë kemi një dispozitë të tillë që e lejon organin e prokurorisë të hetojë çdo lloj veprë penale ndaj deputetëve, por e kufizon në momentin kur duhet të marrë masa që i heqin lirinë deputetëve, nga ky qëllim është nisur që të mos lejojë përdorimin politik të çështjeve të ndryshme. Dhe nuk është një gjë që e kemi vetëm ne. Të gjitha legjislacionet e vendeve që janë më demokratike se ne e kanë të njëjtin parashikim në Kushtetutë e tyre, dhe jo më kot. Deputetët janë figura publike dhe si të tillë ata janë në qendër të kritikave të publikut dhe nganjëherë lehtësisht mund të bëhen shënjestra. Kështu që në këtë kuptim i takon parlamentit të mbrojë trupën e vet dhe të mos lejojë goditjen e trupës së vet, kushdo qoftë, për qëllime mirëfillte të luftës politike. Kjo ka qenë konsiderata e vetme që ne e kemi shprehur publikisht. Nga ana tjetër, është e qartë që qeveria në ndryshim nga ajo që ndodhte në të shkuarën as nuk ka linquar ndonjë nga trupa e prokurorisë, as nuk ka krijuar për shkak të fuqisë e kompetencave të veta ndonjë pengesë në hetimin e çështjes në fjalë apo edhe çështjeve të tjera. Nuk besoj që do të dëgjoni ndonjëherë ndonjë prononcim nga ana e prokurorisë dhe gjykatës që kjo po ndodh në maxhorancën tonë.

**Ka pasur një kërkesë nga opozita drejtuar Presidentit për deklasifikimin e diskutimit që është bërë në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Sigurisë, ku është folur për drogën dhe ka qenë i pranishëm edhe ish-ministri Saimir Tahiri. Presidenti ktheu një përgjigje negative për këtë. Çfarë shërblimi do të sillte nëse deklasifikohet kjo mbledhje?**

Unë besoj se kjo pyetje na rikthen në fillim të bisedës, që për shkak se këtu përhapja e sekreteve në publik është bërë modë, edhe nga fakti se askush nuk është ndëshkuar, nga fakti që ka lejuar përhapjen e një sekreti, duket sikur nuk ka më asnjë sekret. Dhe imagjina arritet në kërkesa të tilla ab-

surde që kur mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare kërkohet që informacionet që ndahen aty brenda, të bëhen publike. Nuk mund të ngrihej në asnjë mënyrë një kërkesë e tillë dhe natyrisht është e drejtë edhe qëndrimi i Presidentit të Republikës. Është një qëndrim konform ligjit për informacionin e klasifikuar. Po ta lexoni atë ligj, që është një ligj i thjeshtë dhe çdo qytetar mund ta kuptojë lehtësisht, do të arrihet në konkluzionin që informacione të natyrës sekrete janë sekrete dhe duhet të ruhen si të tilla deri në afatin që imponon ligji. Nuk mundet që të ndahen me publikun.

**Po afro fundi i mandatit të kryeprokurorit Lla-lla, ndërsa patëm edhe lëvizjen e kreut të SHISH-it, Visho Ajazi. A kanë qenë dhe janë këto lëvizje të ndikuara nga qëllimi që ka Partia Socialiste për të bërë një reformë të thellë në drejtësi?**

Sa i takon lëvizjes së kreut të SHISH-it besoj që kryeministri ka qenë shumë i qartë në deklarimet që ka ndarë me publikun. Nuk kam ndonjë koment për këtë. Është e drejtë e kryeministrit, e drejtë e që të propozojë kreun e ri të SHISH. Në ligj thuhet qartë që kreu i SHISH varet nga kryeministri. Pra, nuk ka asnjë lidhje me komisionin e sigurisë propozimi në fjalë.

Sa i takon pyetjes tjetër për kryeprokurorin, sigurisht nuk është e re, sepse e ka ligji që Prokurori i Përgjithshëm i një vendi ka një mandat të qëndrimit në detyrë që është i njohur. Në momentin që ky mandat përfundon, Kushtetuta ka edhe një zgjidhje të përkrahur qartë se çfarë duhet të vijojë më vonë, e kam fjalën deri në momentin e krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kushtetuta e përkrahur qartë se kush duhet t'i ushrojë funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm, sepse në momentin që do të krijohet Këshilli i Përgjithshëm i Prokurorisë, ai do të zgjidhet nga trupa e prokurorëve.

**Normalisht i bie që kryeprokurori do ta vijojë punën deri në krijimin e Këshillit?**

Është përshkruar qartë në Kushtetutë se çfarë do ndodhë. Le të zbatojmë atë që thuhet në Kushtetutë, pa bërë aludime që nuk i përmban Kushtetuta. Ndryshimet kushtetuese i kemi votuar me unanimitet. Janë 140 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që kanë votuar. Kështu që nuk besoj që na nxjerrim interpretime pas interpretimesh, komente pas komentesh, rri apo nuk rri. Është e qartë, mandatat janë këto që përcaktohen në ligj, në momentin që përfundojnë s'ka asgjë për të diskutuar për askënd që largohet nga një detyrë në të cilën është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

**M**inistria e Mbrojtjes denoncoi në prokurori katër ushtarakë, për dezertim. Katër ushtarakët, pjesë e forcave komando, ishin me mision trajnues në Angli, por nuk janë kthyer në përfundim të trajnimit. Ushtarakët duhet të ktheheshin nga misioni në fund të ditës, por kjo gjë nuk ka ndodhur. Ministria e Mbrojtjes tha se në momentin kur është konstatuar se ushtarakët nuk janë kthyer janë njoftuar autoritetet britanike.



### Shkuan në Londër për trajnim dhe nuk u kthyen në Shqipëri

## 4 ushtarakë shqiptarë dezertojnë, Ministria e Mbrojtjes i denoncon

Më tej është bërë njoftimi në prokurori. Nuk bëhen të ditura identitetet e katër ushtarakëve. Nga ana e saj, prokuroria e Tiranës ka nisur hetimet për akuzën e "Mosparaqitjes në repart". Hetimet kanë nisur nga seksio-

ni ushtarak në prokurorinë e kryeqytetit. Kallëzimi është depozituar saktësisht nga Policia Ushtarake, që është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Prokuroria, sipas burimeve mediatake tha se nga fillimi i tetorit deri në

mesin e nëntorit 2017 janë depozituar nga Policia Ushtarake 16 kallëzime penale kundër efektivëve të ushtrisë që kanë vendosur të thyejnë betimin dhe mos paraqiten në repart. Lidhur me lajmin e publikuar në

media pasditen e djeshme, zyra e shtypit në Ministrinë e Mbrojtjes bën me dije se: 4 efektivë ushtarakë, që kanë qenë duke kryer detyrën e tyre jashtë vendit, nuk janë kthyer në Shqipëri pas përfundimit të saj. Sipas "Kodit Penal Ushtarak", ndaj 4 efektivëve, pranë Prokurorisë së Rrethit, Tiranë është depozituar kallëzim penal "Për dezertim". Prej disa javësh, çështja është në hetim nga ana e autoriteteve përkatëse.

Kryeministri grek shpall 3 ditë zie, mesazhe solidariteti nga vendet e BE

# Përmblytjet në Greqi, 16 viktima, preken 100 familje shqiptare

## Nga 23 të plagosurit, 12 trajtohen në spitale, një i humbur

**1**6 viktima u shënuan nga katastrofa natyrore që goditi të mërkurën tre qyteza të Atikës Perëndimore, pranë Athinës. Nga kjo katastrofë u prekën edhe 100 familje shqiptare, bëhet e ditur në media. Situata paraqitet problematike në Athinë dhe Mandra, një zonë e populluar vetëm 27 kilometra larg kryeqytetit helen. Mësohet se në Mandra jetojnë 600 familje shqiptare, ku 100 prej tyre janë prekur nga përmblytjet. Ndërkohë, në Perama janë 430 familje shqiptare.



të motit në orët e ardhshme edhe në shumë zona të tjera të Greqisë.

Edhe njëherë në të gjithë vendin është hapur debati për veprat publike, zjarret që kanë shkatërruar terrenin, ndryshimin e paligjshëm të shtetërvetë përrenjve dhe lumenjve si dhe ndërtime pa leje që kanë ndodhur në dekadat e fundit. Kryeministri grek pasi shpalli tri ditë zie kombëtare dhe premtoi masa për të ndihmuar familjet dhe bizneset që kanë pësuar dëme. "Dua të shpreh trishtimin tim të thellë dhe ngushëllimet më të sinqerta familjeve të viktimitave, si dhe të premtoj se do të qëndrojmë krah tyre, me të gjitha mjetet që kemi në dispozicion", tha Tsipras, kryeministri i Greqisë. "Është një kohë shumë e vështirë për të gjithë Greqinë", tha ai duke premtuar se do të qëndrojnë pranë të

### Meta, mesazh solidariteti për Presidentin grek, Pavlopoulos

**P**residenti i Shqipërisë, Ilir Meta i ka dërguar një mesazh ngushëllimi homologut të tij grek Prokopis Pavlopoulos për jetët e humbura nga përmblytjet që kanë përfshirë shtetin Helen dy ditë e fundit. Në mesazhin e ngushëllimit, kreu i shtetit shqiptar Ilir Meta uron që mos ketë më viktima në zonat e përmblytura, duke i siguruar se populli shqiptar është me qytetarët e prekur nga kjo katastrofë natyrore. "I tronditur dhe me trishtim të thellë kam ndjekur lajmet për viktimat, të zhdukurit, të lënduarit dhe dëmet e pallogaritshme materiale të shkaktuara nga moti i keq dhe përmblytjet që goditën rrethinat e Athinës", - u shpreh Presidenti shqiptar. "Me shpresën që mos të ketë viktima të tjera në zonat e përmblytura, më lejoni që përmes Jush, t'i shpreh ngushëllimet më të ndjera e të sinqerta familjarëve e të dashurve të viktimitave. Ju siguroj se, në këto momente të vështira e dëshpërimi, unë dhe populli shqiptar jemi me qytetarët e prekur nga përmblytjet, me Ju dhe popullin mik grek", - u shpreh Meta, duke uruar: "Kapërcim sa më të shpejtë të kësaj emergjence natyrore dhe kthim sa më parë në normalitet të jetës së qytetarëve të Athinës dhe të Greqisë!".



dëmtuarve, me të gjitha mjetet e nevojshme, u shpreh kryeministri grek. Ndërsa një prokuror grek urdhëroi hetim urgjent për pasojat që sollën këtë tragjedi.

Kryebashkiaku grek tha në një intervistë se asgjë nuk ka mbetur më në zonën e Mandrës dhe i gjithë qyteti po mban xit për viktimat. Moti i keq ka goditur përsëri në Athinë të enjten. Rugrë në disa pjesë të kryeqytetit grek u kthyen në lumenj. Trafiku është ndërprerë në Athinë në gendrore, për shkak të niveleve në rritje të ujit si rezultat i reshjeve të mëdha në zonë. Trafiku në Autostradën Kombëtare që lidh Athinë dhe Selanikun, gjithashtu, është ndërprerë. Vërshimet kanë goditur edhe qytetet e Janinës, Metsovos dhe Zitës. Mediat lokale kanë raportuar rënie gërrësh dhe shumë baltë në shumë pjesë të rrjetit rrugor. Shërbimet Kombëtare Meteorologjike (EMY) kanë paralajmëruar kushtet më të skajshme të motit edhe gjatë ditëve të ardhshme. Sipas raportimeve, reshjet e mëdha dhe stuhitë do të vazhdojnë, ndërkohë erëra të forta dhe stuhi e breshri janë parashikuar, gjithashtu. Mesazhe ngushëllimi i ka dërguar qeverisë greke presidenti i KE, Jean-Claude Juncker, ndërsa Qipro dhe Turqia kanë shprehur gatishmërinë për të ofruar ndihmën e tyre. "Turqia është e gatshme të ndihmojë Greqinë pas përmblytjeve vdekjeprurëse në Athinë" - ka deklaruar Ministria e Jashtme turke të enjten.

### TAKIMI

Ministrat e Jashtëm të tri shteteve të rajonit mblihdhen sot në Durrës

**M**inistrat e Jashtëm të tre vendeve të rajonit, Shqipërisë, Kroacisë dhe Malit të Zi do të mblihdhen në takimin e dytë Ministror, i njohur si takimi Trepalëshit të Adriatikut. Takimi do të zhvillohet në Durrës në 17 nëntor, me ftesë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati. Kroacia do të përfaqësohet me Zv. kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe Çështjet Evropiane Marija Pejçinovi? Buri?, ndërsa Mali i Zi me ministrin e Punëve të Jashtme, Sr?an Darmanovi?. Trepalëshi i Adriatikut është themeluar në një takim të Ministrave të Jashtëm të tre vendeve, në shkurt të këtij viti në Split, Kroaci. Gjatë këtij takimi, ministrat e tri vendeve do të diskutojnë mbi bashkërendimin e përpjekjeve si tre vende anëtarë në Aleancën e Atlantikut të Veriut për adresimin e sfidave të cilat përballet rajoni i Ballkanit Perëndimor, si dhe për projektet konkrete të vendeve tona në infrastrukturë, energjetikë dhe turizëm.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë. Njësia 10 njofton se me datë 01.12.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paligjshme Apartment me sipërfaqe totale 61.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/190+4-2, volumni 20, faqe 164, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mirir Anif Rruqa dhe Znj.Servete Behxhet Rruqa me vlerë fillestare në ankannd 12.350 (Dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) EURO dhe Apartment me sipërfaqe totale 56.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/190+4-1, volumni 20, faqe 163, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mirir Anif Rruqa dhe Znj.Servete Behxhet Rruqa me vlerë fillestare në ankannd 11.391 (Njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672072580 , email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë. Njësia 10 njofton se me datë 28.11.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paligjshme Apartment me sipërfaqe totale 65 m<sup>2</sup>, rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr pasurie 1/154+4-4, Vol.7, Fq.247, ZK.8350 në pronësi të Z.Lirim Patreli Kocaj, Patreli Hito Kocaj, Fato Mejdo Kocaj, Altin Patreli Kocaj, Agron Patreli Kocaj dhe Elitona Xheladin Kocaj me vlerë fillestare në ankannd 39,000 (Tridhjetë e nëntë mijë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672072580 , email enuar.merko@gmail.com

**NJOFTIM PER SHITJE**  
Ne Zyren e Përbaruesit Gjyqësor Arjan Palla me adresë Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi, H-2, K-3, Ap.-5-Tiranë me dt. 20.11.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë me nr. 1/197 +3-26, vol.8, fq.48, z.k 8260, lloji i pasurisë apartment me sip. 73 m<sup>2</sup> ndodhur ne Tirane, rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa. Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 28405,2 Euro.



Ambasadorja gjermane, Suzanna Schütz: Anëtarësimi në BE pa plotësimin e kushteve, proces i vështirë

# S'ka azil, ambasadorja: Dy rrugët që të sigurojnë punësimin në Gjermani

Çështja "Tahiri": Imuniteti të mos pengojë punën e drejtësisë

Ornela Manjani

Shqiptarët që shkojnë për azil në Gjermani kanë shanse thuajse zero për të përfutur. Ka një rrugë ligjore përmes së cilës çdo person mund të shkojë në Gjermani e të integrohet atje. Sigurimi i një kontrate pune dhe marrja e një vize në Ambasadën Gjermane në Tiranë është e vetmja rrugë që duhet të ndjekin shqiptarët që të emigruar në Gjermani. Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Suzanna Schütz, në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" u sugjeron shqiptarëve të qëndrojnë në vendin e tyre, por për të gjithë ata që duan të ndërtojnë të ardhmen në vendin e saj, Schütz tregon rrugën ligjore që mund të ndjekin. Ambasadorja Schütz bën të ditur gjithashtu se Gjermania mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Europian, por thekson faktin se lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe procesi i vettingut janë jetike për çeljen e negociatave nga Bashkimi Europian për Shqipërinë. Ambasadorja gjermane nuk komenton vendimin e parlamentit për rrezimin e kërkesës së prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, por thekson se para ligjit të gjithë duhet të jenë të barabartë dhe në asnjë rast nuk duhet që imuniteti të përdoret pikërisht për të bllokuar punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë. Nga Kukësi ku ishte për të inauguruar hapjen e Qendrës për Informacion dhe Orientim për të Drejtat Sociale, Migracionin, Arsimin Profesional dhe Karrierën, projekt i financuar nga GIZ-i dhe vihet në zbatim nëpërmjet partneritetit me organizatën të shoqërisë civile, ambasadorja Schütz i rikujton klasën politike shqiptare që të duhet të çojnë deri në fund procesin e vettingut, të luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

**1. Shqipëria është renditur si një nga vendet me numrin më të lartë të azilkerkuesve në Gjermani. Sa janë shanset që një shqiptar të marrë azil në Gjermani? Çfarë rrugë duhet të ndjekin shqiptarët për të shkruar dhe më pas për t'u integruar në shoqërinë gjermane?**

Është një kënaqësi që e bëni këtë pyetje, sepse është shumë e rëndësishme për ne. Vazhdon të ketë shumë shqiptarë, të cilët po shkojnë në Gjermani dhe aplikojnë atje për statusin e



Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Suzanna Schütz

## AMBASADORJA SCHÜTZ

Gjermania mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Europian, por thekson faktin se lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe procesi i vettingut janë jetike për çeljen e negociatave nga Bashkimi Europian për Shqipërinë.

azilantit, megjithëse nuk ka asnjë lloj arsyeje për ta bërë këtë, sepse Shqipëria është vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian dhe si e tillë, këtu për fat të mirë nuk ka përndjekje apo arsye, të cilat do të mundësonin dhënien e statusit të azilantit. Ne rekomandojmë që të gjithë shtetasit shqiptarë të ndjekin për këtë qëllim rrugët ligjore që ofrohen. Duke pasur një kontratë të rregullt pune, ata mund të shkojnë dhe të punësohen në Gjermani për t'u integruar ashtu si ju thatë, në shoqërinë gjermane. Informacioni për këtë mund të merret në qendrën e DIMAK-ut, e cila është një qendër informimi për çështje të migracionit dhe karrierës në Tiranë dhe në rast se shqiptarët paraqesin një kontratë të rregullt pune me një punëdhënës gjerman, e cila

duhet të përmbushë disa kushte, kryesisht kushtin e pagës, mund të paraqiten pranë Ambasadës Gjermane dhe të aplikojnë për një vizë punësimi për të shkruar më pas në Gjermani dhe të punësohen atje. Dëshiroj të plotësoj gjithashtu se ne mbështetim qeverinë shqiptare për të bërë të mundur që të krijohen vende pune për shqiptarët këtu dhe të ketë një zhvillim ekonomik të vendit, i cili të mundësojë qëndrimin e tyre këtu, pikërisht në mënyrë që ata të shfrytëzojnë aftësitë e tyre në vendin e tyre. Ndaj kemi përzgjedhur për këtë udhëtim moton "Dilja në Shqipëri".

**2. Shqipëria po pret hapjen e negociatave për integrimin në Bashkimin Europian. Në gjykim tuaj kur do të hapen negociatat dhe sa po mbështet Gjermania Shqipërinë në rrugën e saj drejt BE-së?**

Gjermania e mbështet Shqipërinë në përpjekjet e saj për të ndërmarrë hapin e radhës për sa i përket integritetit në Bashkimin Europian, pikërisht atë të çeljes së negociatave të anëtarësimit. Për Gjermaninë është njëjaft e rëndësishme që rrugën e integritetit në Bashkimin Europian të plotësohen disa kushte bazë që kanë të bëjnë me prioritet kyçe të përcaktuara nga Komisioni i Bashkimit Europian, që janë para së gjithash reforma në sistemin e drejtësisë, procesi i vettingut, lufta kundër krimit të organizuar dhe

## KERKESA

Ne mbështesim mendimin dhe qëndrimin se Shqipëria duhet të luftojë dhe vendosur kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe në këtë kontekst, organet ligjzbatuese duhet të bëjnë detyrat e tyre.

korrupsionit. Shpresojmë shumë të këto hapa të mund të bëhen deri në progres raportin e ardhshëm të Bashkimit Europian, i cili do të publikohet në pranverë dhe deri atëherë të jetë bërë progresi i duhur dhe i mjaftueshëm.

## DIMAK

Informim dhe këshillim, DIMAK jep këshillim individual ose virtual për mundësitë për punësim dhe zhvillim profesional si në Shqipëri, ashtu edhe në Gjermani dhe lidhur me pasojat dhe rreziqet e migrimit të parregullt. Punonjës të DIMAK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit Tiranë ofrojnë formimin për punësim, që përfshin përgatitje të jetëshkrimit dhe letërmotivimit për punësim sipas standardeve europiane dhe përgatitje për intervista për punësim.



**3. Muajin e fundit Parlamenti shqiptar rrëzoi kërkesën e prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. A ishte ky një mesazh politik për bllokimin e vettingut të drejtësisë?**

Lidhur me rastin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri nuk mund të shprehem, se nuk i njoh detajet e të gjithë procesit, por përgjithësisht mund të them që ne mbështesim mendimin dhe qëndrimin se Shqipëria

luftën e saj kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe shpresojmë shumë që në këtë kontekst të arrihen rezultate konkrete. Përpara ligjit të gjithë duhet të jenë të barabartë dhe në asnjë rast nuk do të duhet që imuniteti të përdoret pikërisht për të bllokuar punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

**4. Në Shqipëri sapo ka nisur procesi i vettingut. Mendoni se ky proces do të pastrojë sistemin e drejtësisë nga të inkrimnuarit dhe si i komentoni deklaratat e ambasadorit amerikan në Shqipëri, Donal Lu për arrestimin e "peshqve të mëdhenj"?**

Krimi i organizuar është një problem që duhet të zgjidhet patjetër, është një prej kushteve themelore që Bashkimi Europian ka vendosur në kuadër të procesit të integritetit. Ne e përsërisht shprehimisht faktin se procesi i vettingut tashmë ka filluar, megjithëse ka pasur përpjekje të ndryshme për ta ngadalësuar këtë proces. Ju e dini tanimë që ne mbështesim dhe konkretisht kemi mbështetur me kontribute procesin e vettingut, përmes misionit EURAILUS. Të gjithë e dimë që procesi vettingut është i rëndësishëm, i vështirë dhe i paprecedentë, është një proces i cili nuk ka të ngjashëm të vetët në vend apo në rajon, prandaj bëhet më i rëndësishëm fakti që të gjithë pjesëmarrësit të mund ta realizojnë këtë proces me seriozitetin më maksimal të mundshëm. Të vënë në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme, në mënyrë që të krijohet një ide dhe një panoramë sa më e qartë rreth personave. Shpresa është që sistemi i drejtësisë në fund të jetë një sistem i pastuar nga radhët e të inkrimnuarve. Në do të jetë 100% i tillë, kjo është diçka e diskutueshme, por ky është gjithsesi objektivi ynë.

**5. Komentoni juaj për deklaratën e ambasadorit Lu??**

E thashë pak më parë, ne jemi me të njëjtin qëndrim si amerikanët se, krimi i organizuar duhet të luftohet me vendosmëri maksimale dhe se të gjithë ata persona, të cilët akuzohen për vepra kriminale, sigurisht që duhet të ndiqen dhe të dënohen. Kjo ka të bëjë sigurisht para së gjithash edhe me kokat e strukturave kriminale.

Në shqyrtim dosja CEZ për transfertën e 6.8 mln euro dhe e Mark Frrokut për vrasjen në Belgjikë

# Nis procesi i vetingut në prokurorinë e Tiranës

## Në "sitë" katër emrat e çështjeve më të bujshme

TIRANË

Është hedhur dje shor ti për nisjen e procesit të vetingut në prokurorinë e Tiranës. Mësohet se në filtër do të jenë prokurorët që garojnë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Pas shortit të hedhur pritet të verifikohen dosjet e prokurores Antoneta Sevdari, e cila ka përfaqësuar akuzën në çështjen "CEZ". Gjithashtu, në kontroll do të kalojnë dhe dosjet e prokurorit Adriatik Cama, i cili ka përfaqësuar organin e akuzës në gjyq, në procesin ndaj ish-deputetit Mark Frroku.

### PROKURORËT

Antoneta Sevdari është prokurorja që ka çuar në gjyq një nga dosjet e CEZ, me të akuzuar Kastriot Ismailaj dhe Josef Hajsek. Ismailaj u akuzua për tre vepura penale, mashtrim me pasojë të rënda me borxhet e CEZ, rreth 5 milionë euro, pastrim parash dhe falsifikim dokumentesh. Kjo



Prokuroria e Tiranës

çështje është mbyllur me sekuestrimin e 5 mln eurove që kanë kaluar në arkën e shtetit dhe dënimin e Ismailajt me 15 vjet burg. Ndërsa mazhoranca e ka akuzuar prokurorinë se për aferën e çështjes CEZ ajo nuk po heton deklaratat e personave të përfshirë në të, ndërkohë që në Çeki një hetim i tillë po bëhet. Gjithashtu, dyshohet se Nue

Kalaj, personi i akuzuar se ka luajtur rolin e sekserit për marrëveshjen e privatizimit të OSSH, ka marrë 7 milionë euro para zgjedhjeve të 2009-s në llogaritë e tij bankare nga CEZ. Në kontroll do të jenë edhe dosjet e Adriatik Camës, i cili ka përfaqësuar akuzën në gjykimin ndaj ish-deputetit Mark Frroku, i cili akuzohet për kryerjen e një

### BIZNESMENI

#### KASTRIOT ISMAILAJ

Biznesmeni Kastriot Ismailaj, ish-administratori i DIA-s ka apeluar dënimin me 11 vjet burg, caktuar nga Shkalla e Parë në 25 tetor të këtij viti. Ai kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së Tiranës dhe deklarimin e tij të pafajshëm për akuzat e ngritura ndaj tij.



vrasjeje në Belgjikë. Prokuroria e ka ankmuar vendimin për pafajësinë e Frrokut të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në

### VENDIMI

#### Dosja "Miri", KLD do të vendosë për pezullimin ose jo të gjyqtarit

Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të mbledhet pasditën e së premtes për të vendosur rreth fatit të Shkëlqim Mirit, gjykatësit të arrestuar pas dyshimeve për korrupsion. Institucioni që konsiderohet si qeverisja e gjyqësorit pritet të marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorisë për Krime të Rënda, për pezullimin nga detyra të gjykatësit të Apelit Tiranë, deri në përfundim të procesit hetimor e gjyqësor ndaj tij. Prokuroria i ka dorëzuar këshillit masën e sigurisë që gjykata caktoi ndaj 46-vjeçarit, ku renditen disa nga provat kryesore, mbi bazën e të cilëve ai mbahet prapa hekurave. Sipas organit të akuzës, gjyqtari në këmbim të parave, dyshohet se favorizoi të dënuarin Gentian Doda të linte qelë, për shkak se i ndryshoi akuzën nga "Vrasje me paramendim" në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen.



Shkëlqim Miri

filtër nga organet e vetingut ish-drejtues i prokurorisë së do të kalojnë edhe dosjet e Tiranës dhe prokurorit Dritan Rreshka.

### REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTANCY COMPANY)

#### ALBANIA

CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT  
Loan Agreement  
Project ID No. 8521

Assignment Title: Advisory Support for Validation of Services provided with Improved Front Office

Ref. No. ALB-8521/CS/CQ/3.10.02

As part of the reform, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA), was established in October 2014 to manage the centralized public service delivery to the citizens. Its expanded mandate includes the implementation of the separation of the front office (FO) from the back office (BO) in all central institutions, aiming to improve access to public services as well as the quality of service delivery through establishing of service, based on a customer-care culture.

To implement the program, the Government of Albania has received financing from the World Bank. The Project Management Unit, the Ministry of Innovation and Public Administration (MIPA) as the lead implementation agency supported by the Delivery Unit at the Prime Minister's Office, and ADISA, as beneficiary agency under the ISDA program, manages the technical aspects of the activities.

Under the second pillar, the program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model, through establishing integrated centers/ one-stop shops. ADISA is currently managing one front office at IPRO in Tirana and four One Stop Shops in four different cities. These new facilities offer citizens and businesses improved physical access to public services, with improved customer service culture and standards regarding the delivery, aiming for reduced transactions time and a reduction in petty corruption.

The results of key activities are linked to Disbursement Linked Indicator (DLI#3) - Services offered with improved customer service front office interface - that will be verified/ validated through a third party. For this purpose, ADISA is seeking a consulting company (hereafter referred to as the Consultant) to conduct such verification exercise. The Consultant is expected to develop the methodology, conduct data collection and analysis, and prepare the findings/verification/ certification report.

The scope of work is to conduct an in-depth assessment to measure (a) improved access to services and (b) improved quality of services, as measured by professionalism, courtesy of staff, queue management and waiting times; easiness of application process, standard application forms, personnel dressing and presentation, information desk, complaint management, etc.

The key tasks and main activities the Consultant is expected to carry out include, but not limited to, the following:

- Design a comprehensive and clear methodology proposing multiple method approach to gather the needed information (both qualitative and quantitative), in order to reach all target groups. Some potential data sources could include, but might not be limited to, exits surveys, direct observations, focus groups, etc. Secondary data would be useful to use as well to complement the primary ones.
- Design the instruments for data collection to make sure all necessary data on access, customer service, corruption, etc., are collected. The data collection instruments should be agreed upon with the Client/ADISA before implementation.
- Implement the agreed methodology to collect the necessary data. The data collection should be carried in multiple location (all FO/OSSH) to allow also for comparisons of the number of services available at each location, etc.

- Perform data analysis and produce the verification report.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- At least 10 (ten) years of professional consulting experience with a focus on assessment, in-depth review of customer services at front offices operation in public or private sector.
- Proven experience in designing and implementing research methodology, including both qualitative and quantitative approaches.
- Previous experience in World Bank funded projects and/or DLI verification will be an advantage.
- Fluency in English language, spoken and written (for key members of the team); and
- Availability of staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

**The Team Leader /Survey Researcher** shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree and demonstrated experience in economics, business management, development economics, or related fields;
- (b) Minimum of ten (10) years professional experience in designing and implementing of assessment related to customer service in public or private sector as well as proven experience as team leader;
- (c) Proven experience in carrying out/ leading such assignments/ third party verification, working for large institutional donor supported projects.

**The Fieldwork Coordinator**, who is expected to administer the foreseen field activities, and provide technical oversight and guidance to the field team to ensure collection of quality data, shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree or demonstrated experience in economics, business management, or related fields;
- (b) Minimum of five (5) years professional experience in managing field activities and ensuring compliance with the survey methodology at all levels of data collection;
- (c) Very good understanding of customer service in public or private sector;

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): [www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al).

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 30, 2017, at 12.00 local time

Project Management Unit Blvd: Zhan d'Ark,  
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te Tirana, Albania  
E-mail: [roland.larashi@inovacioni.gov.al](mailto:roland.larashi@inovacioni.gov.al); and  
[ccsdprojectalbania@gmail.com](mailto:ccsdprojectalbania@gmail.com)



**Synohet parandalimi i aksidenteve e rritja e sigurisë**

**Policia rrugore, gjoba për këmbësorët që nuk respektojnë rregullat**

Këmbësorët që nuk do të respektojnë rregullat e qarkullimit do të përballen me masa administrative. Kjo është bërë e ditur nga Policia Rrugore, sipas të cilës masat synojnë parandalimin e aksidenteve rrugore, rritjes së parametrave të sigurisë në rrugë, si dhe nga analiza e bërë shkaqëve të aksidenteve të ndodhura ditë e fundit, ka hartuar një plan të ri masash. Në këtë plan të ri, janë përcaktuar:

planimetria e vendosjes së shërbimeve; mënyra e kombinimit të radarëve në akset rrugore të brendshme, por edhe në akset nacionale që lidhen me Tiranën me qëllim evidentimin dhe ndëshkimin e drejtuesve të mjeteve që qarkullojnë me shpejtësi tej normave të lejuara; koordinimi i shërbimeve me patrullat e përgjithshme dhe "Shqiponjat" duke evidentuar dhe ndëshkuar në kohë, në çdo aks rrugor shkelësit e Kodit Rrugor; kontrolli në mënyrë të pandërprerë me



aparatin "Drager" për parandalimin e përdorimit të alkoolit gjatë drejtimit të mjetit. Nisur nga analizimi i rasteve të fundit të aksidenteve, rezultoi se kemi një shtim të shkeljes së rregullave të qarkullimit nga këmbësorët.

**30-vjeçari, i skeduar nga policia**

**Sherri te Unaza e Re, qëllohet me armë zjarri Gentjan Rrahmani**

TIRANE - Një sherr i ndodhur ditën e djeshme te Unaza e re në Tiranë, mes disa të rinjve, ka përfunduar në plagosjen e Gentjan Rrahmanit. 30-vjeçari është plagosur nga një person tjetër dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën në Spitalin e Traumës. Mësohet se i plagosuri Gentjan Rrahmani është një personazh i njohur për policinë. Ai është shqetësuar disa herë nga uniformat blu për vepra të ndryshme penale dhe njëherë si person problematik në zonë. Burime nga policia e

Tiranës sqaruan se fillimisht në rrugën "Teodor Keko", Gentjan Rrahmani bashkë me një shokun e tij, kanë qëlluar me tulla një person tjetër, duke i thyer edhe xhamin e makinës. I riu që është dëmtuar, pasi ka hipur në makinë ka nxjerrë një pistoletë dhe ka qëlluar Gentjan Rrahmanin. Autori ka qëlluar me një plumb 30-vjeçarin në pjesën e pasme pranë shtyllëz kurrizore. Autori më pas është larguar me makinë dhe pavarësisht kontrolleve të shumta, nuk u arrit të arrestohej. Mësohet se të sh-



tënat nga pistoletat nuk kanë prekur asnjë prej kalimtarëve, por vetëm Gentjan Rrahmanin. Policia e Tiranës ka shoqëruar disa persona të dyshuar si autorë të ngjarjes, ndërkohë që pritet të merret në pyetje edhe shoku i Gentjan Rrahmanit.

**Zbardhet skema e grabitjes së 36 ha tokë në bregdetin e Spillesë**

**Abuzimi me pronat, dorëzohet në polici ish-kreu i Hipotekës në Kavajë**

**Gjykata jep 'arrest me burg' për 8 zyrtarët**

Pas skandalit të zbuluar në Kavajë, ku zyrtarë të lartë të Hipotekave ishin përfshirë në një rrjet të gjerë korrupsioni të tjetërsimit të tokës, është vetëdorëzuar dhe në polici Seid Cikalleshi, ish-kreu i këtij institucioni. Mësohet se Cikalleshi është vjeçhari i kryetarit të Partisë Socialiste në Kavajë, Gentian Daja. Ndërkohë gjykata e Kavajës ka caktuar dhe masën e sigurisë "Arrest me burg" për 8 ish-zyrtarët dhe zyrtarët e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nën akuzën e shpërdorimit të detyrës. Nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, zyrtarët kanë tjetërsuar 36 hektarë në bregdetin e Spillesë, duke ua kaluar në pronësi shtetasve të ndryshëm. Gjykata e Kavajës ka caktuar dhe masat e sigurisë për të arrestuarit gjatë këtij operacioni policor, dhe ka rikonfirmuar arrestin me burg për shtetasit Seid Cikalleshi, ish-kryeregjistruesi i Hipotekës së Kavajës; Fatos Kaja ish-zyrtar i komunës Kryeviidh, Kavajë (aktualisht, nën-prefekt i qarkut Tiranë); Dritan Kazazi hartograf, ZVRPP, Kavajë; Andi Gjeci jurist, ZVRPP, Kavajë; Ilir Kaja zyrtar i Njësisë Administrative Kryeviidh, Kavajë; Nezir Lecini ish-shef i Zyrës së Kadastrës, Kavajë; Agron Xhelezi ish-kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokave, Kavajë; Enver Duqi ish-drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Kavajë. Sakaq sot pritet të dalin para kësaj gjykate 3 persona të tjerë, Altin Çoba, drejtor i ALUIZNI-Kavajë, Behgjet Pjeci, ish-kryetar i komunës Kryeviidh dhe Dashnor Çullhaj, ish-zyrtar i komunës Kryeviidh Kavajë, të cilët janë ndaluar në 14 nëntor nga prokuroria e Kavajës.



Seid Cikalleshi, ish-kreu i hipotekës në Kavajë

**SKEMA E GRABITJES**

Rreth 2 vjet më parë, Spiro T., banor i fshatit Rreth Greth të Rrogogzhinës u informua nga ish-agronomi i komunës, Ilir Kaja se do të bëhej pronar i 3 mijë metrave tokë në bregdet. "Meqenëse je hallexhi dhe keq nga gjendja ekonomike do të të pajisim me rreth 3 mijë metra katrorë tokë," i ka premtuar Kaja gjatë një takimi mes tyre në qendër të fshatit. Në dëshminë e tij për prokurorinë e Kavajës, Spiro T. ka pohuar se nuk kishte parë asnjë dokument pronësie dhe as nuk e dinte se ku ndodhej toka "e premtuar". Por Kaja i kishte sugjeruar në një takim të dytë që bashkë me të shoqen dhe djalin të paraqiteshin te noteri për të bërë shitjen dhe ai ish-

te bindur. Dokumentet e hetimit të siguruar nga BIRN tregojnë se Spiro T. firmosi aty ku i tha noteri, duke e ditur se po shiste 3 mijë metra tokë për 1.5 milionë lekë dhe mori me këste dorazi nga Kaja 1.2 milionë. Sipas prokurorisë, ai nuk ishte në dijeni se në emër të tij ishin tjetërsuar 15 700 metra katrorë tokë në bregdetin e Spillesë-pjesë e një sipërfaqe prej 36 hektarësh që u vodh shtetit përmes një kapice dokumentesh të falsifikuara nga disa institucione lokale, për të cilët akuzohen 11 zyrtarë. Spiro T. ishte vetëm njëri prej 108 banorëve të zonës, emrat e së cilëve u përdorën në skemën e tjetërsimit të tokave përmes dokumenteve të falsifikuara. Dokumentet e hetimit tregojnë



**VENDIMI I GJYKATËS SË KAVAJËS**

1. Seid Cikalleshi, ish-kreu i Hipotekës, Kavajë
2. Dritan Kazazi, hartograf, ZVRPP, Kavajë
3. Andi Gjeci, jurist, ZVRPP, Kavajë
4. Fatos Kaja, ish-zyrtar i komunës Kryeviidh, Kavajë (aktualisht, nën-prefekt i qarkut Tiranë)
5. Ilir Kaja, zyrtar i Njësisë Administrative Kryeviidh, Kavajë
6. Nezir Lecini, ish-shef i Zyrës së Kadastrës, Kavajë
7. Agron Xhelezi, ish-kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokave, Kavajë
8. Enver Duqi, ish-drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Kavajë

se toka e tjetërsuar fillimisht në emër të banorëve të zonës u kaloi përmes kontratave të shitjes apo të dhurimit të afërmeve të pushtetarëve lokalë të Kavajës, ku kryeson rrethi familjar i ish-kryetarit

të Bashkisë, Elvis Rroshi; kryetarit të PS në Kavajë Gentian Daja; nën-prefektit të Tiranës Fatos Kaja, ish-shefit të Zyrës së Kadastrës në Kavajë, Nezir Lecini si dhe të afërmit të gjyq-tarit Luan Lusha.

**SHKURT**

**Rinas, biznesmenit italian i sekuestrohen 350 mijë euro të padeklaruara**

Një biznesmeni italian i janë bllokuar në Rinas 350 mijë euro. Bëhet fjalë M.C. 51 vjeç i lindur në Tradate. Biznesmeni 51-vjeçar që po udhëtonte drejt Italisë, ishte përzgjedhur për verifikim në vijën e dytë të kontrollit dhe iu gjetën e sekuestruan në dytë ku gjatë kontrollit iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një sasi prej 350000 euro, shumë të cilën nuk e kishte deklaruar në zyrën doganore. Policia e Rinasit ka sekuestruar vlerën monetare dhe po e procedon 51-vjeçarin në gjendje të lirë për veprën penale "Mosdeklarim në kufi i të hollave ose sendeve me vlerë".

**Iu gjetën 863 mijë euro e Patentat e Tahirët, Orest Sota kërkon lirinë**

Biznesmeni 25-vjeçar, Orest Sota, i cili u kap me 863 mijë euro dhe patentat e Saimir Tahirët në makinë, kërkon lirinë në Gjykatën e Apelit të Durrësit. Shkalla e parë e Elbasanit ka dhënë masën e arrestit me burg për të për tri akuzat: fshenje të të ardhurave, kundërshtim të urdhrit të policisë dhe drejtim automjeti pa leje. Ende nuk ka vendim nga Apeli i Durrësit, por ky ankimim ka penguar dhe zhvillimin e rivlerësimit të masës së Sotës pranë Krimeve të Rënda. Masa për Orest Sotën të Gjykata e Krimeve të Rënda pritet të zhvillohet me 20 nëntor.

Organizata kriminale bashkëpunonte me klanet mafioze bareze, Di Cosimo e Parisi

# Trafik droge Holandë-Itali, arrestohen 14 persona, 6 prej tyre shqiptarë

## Kokaina e sjellë nga Amerika me vlerë 4 mln euro

ITALI

**LIDHJET ME MAFIEN ITALIANE**

Policia italiane në bashkëpunim me atë holandeze kanë zbuluar dhe goditur një organizatë kriminale që merrej me trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Superoperacioni antidrogë është finalizuar me sekuestrimin e një sasive prej afro 1 ton kanabis sativa. Ndërkohë, kanë përfunduar 14 persona, mes të cilëve 6 shqiptarë. Mësohet se hetimet janë kryer nga antimafia e Firences dhe autoritetet gjyqësore holandeze. Sipas burimeve nga vendi fqinj, personat e arrestuar gjatë operacionit të kryer në Firence, Amsterdam dhe Rotterdam akuzohen për trafik ndërkombëtar droge, armëmbajtje pa leje armësh si dhe riciklim parash. Po të njëjtat burime thanë se fitimet e shitjes së drogës investoheshin në prostitucion.

**HETIMET**

Policia e Firences i ka nisur hetimet e këtij operacioni në maj të vitit 2015 nën drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme Antimafia e me urdhër të Prokurorisë së qytetit të Firences. Nga hetimet e kryera është bërë e mundur zbulimi i organizatës kriminale, kryesisht e përbërë nga shqiptarë, të cilët trafikonin lëndë narkotike nga Amerika e Jugut përmes Holandës në Itali dhe Angli si dhe riciklonin paratë e përfituara nga biznesi i drogës. Gjithashtu, nga hetimet e kryera ka rezultu-

ar se kjo organizatë kriminale bashkëpunonte me dy klanet mafioze të qytetit të Bari Di Cosimo e Parisi. Në kuadër të hetimeve, në maj, në Bari u arrestuan eksponentë të shquar të dy klanëve bareze, të cilët kishin gjetur te organizata shqiptare një kanal të qëndrueshëm të furnizimit me drogë, e cila më pas shitej në sheshet



kryesore të qyteteve të Puljas. Përgjatë hetimeve të këtij operacioni janë sekuestruar 140 kg kokainë në vlerë 4 milionë euro; 700 kg marijuanë; 4 milionë euro cash; 8 armë zjarri dhe një granatë. Në sekuestro janë vënë dhe disa banesa e automjete në Holandë si dhe një biznes tregtar. Hetimet e fundit kanë vërtetuar se ky grup kriminal ishte i gatshëm të trafikonte në tregun italian rreth 20 kg kokainë rreth 97% e pastër në çdo dy javë. Po gjatë këtij operacioni, janë vënë nën hetim 30 persona, të cilët dyshohen si bashkëpunëtorë më anëtarët e këtij grupi kriminal.

Edhe një vit më parë në 2016-ën, në operacionin "Toka Jonë" mes të arrestuarve kishte një numër të madh shqiptarësh të lidhur me familjet mafioze. Një operacion që zgjati afro një vit dhe kishte zbuluar një shpërndarje të drogës

nga Milano në pjesën tjetër të Italisë. Por hetuesit italianë theksojnë se dihet ende pak për familjet dhe klanet që përbëjnë mafien shqiptare dhe lidhjet që ata kanë në Itali. Një nga pistat është se trafikantët shqiptarë janë lidhur me

**4**

**MLN EURO**

Përgjatë hetimeve të këtij operacioni janë sekuestruar 140 kg kokainë në vlerë 4 milionë euro, 700 kg marijuanë, 4 milionë euro cash, 8 armë zjarri dhe një granatë. Në sekuestro janë vënë dhe disa banesa e automjete në Holandë, si dhe një biznes tregtar.

familjet e Sacra Corona Unita - mafia e Pulias - me anë të martesave mes anëtarëve të bandave dhe vajzave të familjeve mafioze italiane.



**Misteri, shqiptari digjet i gjallë brenda në makinë**

**GREQI** - Një shqiptar ka humbur dje jetën në mënyrë tragjike në lagjen "Vuliagmeni" në Athinë, pasi ai është djegur i gjallë brenda makinës. Ngjarja u regjistrua pak para orës 10:00 pranë portit sipas orës lokale. Mediat greke raportojnë se bëhet fjalë për një 50-vjeçar shqiptar. Nga hetimet e deritanishme rezultoi se targa e makinës së djegur i përkasin pikërisht shqiptarit, ndërsa identitetin e tij nuk e kanë bërë me dije. Makina tip "Citroen" është djegur tërësisht, po kështu edhe viktimja që ndodhej në sediljen e shoferit. Pas kryerjes së hetimeve paraprake ka rezultuar se zjarri ka rënë nga brenda automjetit, kurse shkaqet janë ende të paqarta. Ndërkohë, kufoma është dërguar në departamentin e mjekësisë ligjore për t'u kryer autopsia. Sakaq, policia e Athinës ka nisur hetimet për ngjarjen dhe ka lënë të hapura të gjitha pistat.

**"Ura e Muhurrit", shpallet në kërkim një tjetër**

Transportonin 20 kg kanabis me makinë, arrestohen dy persona nga Tirana

**DIBËR** - Policia e Dibrës ka sekuestruar një sasi prej 20 kg kanabis, ndërsa ka arrestuar në flagrancë dy persona dhe ka shpallur në kërkim një tjetër. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Ura e Muhurrit", u vunë në pranga 47-vjeçari Asllan Cani dhe 22-vjeçari Ervin L., të dy banues në Tiranë. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Dibrës pohuan se specialistët e sektorit të Antidrogës në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, gjatë orëve të mbrëmjes të së mërkurës kanë goditur një tjetër rast. Mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative se dy shtetas po transportonin me një automjet lëndë narkotike në aksin rural Zall-Dardhë-Muhurr. menjëherë kanë organizuar punën për goditjen e këtij rasti. Si rezultat i ndërhyrjes së befasishme të policisë në vendin e quajtur "Ura e Muhurrit" është bërë ndalimi i automjetit tip "Suzuki", me targa AA 084



Arrestimet gjatë operacionit antidrogë në Dibër

FS dhe me drejtues shtetasin Asllan Cani. Gjatë kontrollit në pjesën e bagazhit të automjetit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 thasë me lëndë narkotike me peshë totale 20 kg kanabis sativa. Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë kapja në flagrancë e 47-vjeçarit Cani dhe 22-vjeçarit Ervin L., të cilët akuzohen për veprën penale: "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" kryer në bashkëpunim. Ndërkohë, u shpall në kërkim policor shtetasi R.C.,

29 vjeç, banues në Tiranë, i cili akuzohet për veprat penale: "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" kryer në bashkëpunim dhe "Mosbindje ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë". Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan edhe dy aparate celularë dhe automjeti, me të cilin lëviznin tre personat e mësipërm. Materialet hetimore do t'i kalojnë prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprime të mëtejshme. en.do.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject:** Request for proposal "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP/2017-42582 "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning"**.

For more details please refer to the link below:  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=42582](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42582)

**Relevant dates:** All interested entities should provide their proposal, not later than **4 December 2017, 14:00 hrs**, to the address:

United Nations Development Programme  
 "Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,  
 Tirana, Albania  
 UNDP Procurement team



Konflikti mes palëve nisi në Suedi dhe degjeneroi me 1 të vranë e 2 të plagosur në 2015-ën

KURBIN

# Masakra e Mamurrasit, prokuroria kërkon 107 vjet burg për 4 persona

## Pretenca për 2 vëllezërit Mamli e 2 kushërinjtë Tafa

Prokuroria e Kurbinit ka kërkuar dënimin me 107 vjet burg për 4 persona, të cilët akuzohen për masakrën e Mamurrasit. Ngjarje kjo e ndodhur dy vite më parë në qendër të këtij qyteti, ku mbeti i vranë një persona si dhe u plagosën dy të tjerë. Burime zyrtare nga organi i akuzës dhe bënë me dije se të pandehurit Elton Mamli dhe Tom Mamli, vëllezër me njëri-tjetrin, më 23 shtator të vitit 2015 janë përfshirë në një konflikt të armatosur me kushërinjtë Gazmir dhe Taulant Tafa, në Mamurras, pranë stacionit të trenit. Mësohet se gjatë konfliktit me armë mbeti i vdekur Naim Tafa, i përfshirë në përlëshje. Ndërkohë që u plagosën rastësisht shtetasit: Idriz Tafa dhe Altin Çoku, të cilët gjendeshin bashkë me shumë persona të tjerë, në zonën e stacionit të trenit. Në përfundim të gjyqimit, Prokuroria e Kurbinit kërkoi dënimin me 33 vite burg për Tom Mamlin, 26 vite burg për Elton Mamlin, 24 vite burg për Gazmir Tafën dhe 24 vite burg për Taulant Tafën. Të katër personat në fjalë akuzohen për veprat penale "Vrasje në rrethana cilësuese" dhe "Mbahje pa leje të armëve luftarake". Gjithashtu, Prokuroria e Kurbinit kërkoi dënimin me 2 vjet burgim për shtetasin Dorian Mamli, i akuzuar për "Moskallëzim krimi".

### HETIMET

Burime nga Prokuroria e Kurbinit pohuan se nga hetimet e kryera ka rezultuar se konflikti ndërmjet familjeve Tafa dhe Mamli ka filluar kohë më parë në Suedi, ku janë përplasur fizikisht për motive të dobëta kushërinj të pandehurve Tafa, Edmond Tafa me vëllezërit Mamli. Ky konflikt ka vijuar edhe në Shqipëri. Rreth një muaj para ngjarjes, i dëmtuari në Suedi, Edmond Tafa dhe i pandehuri Gazmir Tafa kanë rrahur

**NGJARJA**  
Konflikti i armatosur ka ndodhur në një moment, kur ambienti përreth ka qenë i populluar me shumë njerëz. Nga goditjet me armë, ka mbetur i vdekur Naim Tafa, i cili ndodhej nën shoqërinë e kushërinjtë Tafa. Nga ekspertiza, rezultoi se ai është vranë nga arma e përdorur nga Tom Mamli. Po ashtu, nga goditjet me armë, kanë mbetur të plagosur edhe Idriz Tafa dhe Altin Çoku, të cilët gjendeshin rastësisht në vendin e ngjarjes.



Viktima, Naim Tafa

në Mamurras Elton Mamlin. Pas kësaj ngjarjeje, vëllezërit Mamli kanë debatuar edhe me kushërinin e tyre, Dorian Mamli, për faktin se ky i fundit shoqërohej me Tafajt, të cilët ishin "kundërshtarët e tyre". Por, pavarësisht presionit, Dorian Mamli nuk ka pranuar të shkëpusë marrëdhëniet me Tafajt dhe për këtë arsye, ditën e ngjarjes, më 23 shtator 2015, vëllezërit Elton dhe Tom Mamli kanë rrahur kushërinin e tyre, Dorian Mamlin. Pas kësaj episode, vëllezërit Mamli janë larguar me mjete të tyre "Range Rover". Ndërsa Dorian Mamli është takuar me kushërinjtë Tafa, të cilëve u ka treguar për ngjarjen. Këta të fundit

(Tafajt) kanë dalë me mjete të tyre, tip "Benz", në kërkim të vëllezërve Mamli. Të dy palët janë përballur me njëri-tjetrin pranë stacionit të trenit dhe fillimisht kanë përplasur mjete të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pas përplasjes, të dy palët, të armatosur, kanë dalë nga mjete dhe kanë qëlluar kundër njëri-tjetrit. Konflikti i armatosur ka ndodhur në një moment, kur ambienti përreth ka qenë i populluar me shumë njerëz. Nga goditjet

### PRETENCA E PROKURORISË SË KURBINIT

1. Tom Mamli të dënohet me 33 vjet burgim
2. Elton Mamli të dënohet me 26 vjet burgim
3. Gazmir Tafa të dënohet me 24 vjet burgim
4. Taulant Tafa të dënohet me 24 vjet burgim
5. Dorian Mamli me 2 vjet burgim, i akuzuar për "Moskallëzim krimi".

### KONFLIKTI

Burime zyrtare nga prokuroria e Kurbinit dhe bënë me dije se nga hetimet e kryera ka rezultuar se konflikti ndërmjet familjeve Tafa dhe Mamli ka filluar kohë më parë në Suedi, ku janë përplasur fizikisht për motive të dobëta kushërinj të pandehurve Tafa, Edmond Tafa me vëllezërit Mamli. Ky konflikt ka vijuar edhe në Shqipëri.

me armë ka mbetur i vdekur në vend shtetasi Naim Tafa, i cili gjendej nën shoqërinë e kushërinjtë Tafa. Nga ekspertiza, rezultoi se ai është vranë nga arma e përdorur nga Tom

Mamli. Po ashtu, nga goditjet me armë, kanë mbetur të plagosur edhe shtetasit Idriz Tafa dhe Altin Çoku, të cilët gjendeshin rastësisht në vendin e ngjarjes.

### SHKURT

**Iu gjetën municione në banesë, bie në pranga zjarrfikësi**

**PUKË** - Një punonjës i Zjarrfikëses në Pukë ka përfunduar dhe në pranga, pasi nga kontrolli në banesë iu gjetën municione, por edhe një palë pranga policie. Burime nga policia lokale bënë me dije se kishte mbledhur informacione në rrugë operative për të kontrolluar banesën e 48-vjeçarit M.Gj., punonjës në PMNZSH Pukë. Gjatë kontrollit të ushtruar në bodrumin e banesës së tij u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 686 fisheke automatikë; 374 fisheke pistolette "TT"; 4 kërehra automatiku dhe një palë pranga si të policisë. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për veprën penale: "Mbahja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit".

**Vidhet gomonia, dyshohet, se do të përdoret për trafik narkotikësh**

**HIMARË** - Mbrëmjen e së mërkurës, persona ende të paidentifikuar kanë vjedhur një gomone në një banesë në fshatin Iljaz të Himarës. Mësohet se agresorët kanë hapur derën e jashtme të shtëpisë në pronësi të arsimitores Loreta Baxhaku dhe bashkëshortit të saj dhe pasi e kanë bastisur atë, janë larguar nga shtëpia me mjete lundrues që ndodhej në oborr. Sipas bluve, vjedhja është konstatuar nga babai i mësueses kur ka shkuar në mëngjes dhe ka gjetur derën e shtëpisë të hapur. Menjëherë të zotët e banesës kanë denoncuar ngjarjen. Ata kanë pohuar se kanë frikë se gomonia mund të përdoret për trafik droge dhe apojejnë që të nisnin kërkimet sa më parë.

**belleair**  
Shpk, Shoqëri në Faliment

### NJOFTIM PËR SHITJE NGA MBLLEDHJA E OFERTAVE PUBLIKE

- Administratori i Falimentit Arjeta Çumani njofton shpalljen për shitjen e pajisjeve informatike, mobiljeve dhe orndevit të "Belle Air" shpk, sipas listës bashkëngjitur.
- Shitja e objekteve do të bëhet nëpërmjet mbledhjes së ofertave publike dhe objektet që janë në shitje ndodhen pranë Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë dhe mund të kontrollohen çdo ditë nga ora 10:00-16:00.
- Objektet do të shiten me një vlerë okazion, 20% më pak sesa vlera e aktiveve e paraqitur në bilancin e masës së falimentit.
- Vlera e aktiveve që ofrohen për shitje nuk është as vlera minimale e pranueshme dhe as çmimi i detyrues për tu marrë në referencë gjatë përgatitjes së ofertave të subjekteve.
- Të gjitha ofertat do të dorëzohen me shkrim, me zarf të mbyllur, duke specifikuar aktivin për të cilin është shpallur procedura e mbledhjes së ofertave publike.
- Çdo pjesëmarrës duhet të depozitojë të paktën 3 ditë përpara zhvillimit të shitjes jo më pak se 20% e vlerës së aktivit për shitje të paraqitur në tabelën bashkëngjitur, pranë logarisë bankare të administratores së falimentit AL492041101700000000032267.
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është data 27 Nëntor 2017 ora 15:00 dhe dokumentat për pjesëmarrje në këtë shitje do të dorëzohen deri në 15 min më përpara hapjes së ankandit që do të zhvillohet në Pallatin e Kulturës, Tiranë. Ofertat do të hapen në prani të noterit.
- Pas vlerësimit të ofertave, ku secili prej subjekteve do të jetë prezent në hapjen e tyre, do të shpallet fitues ai subjekt që do të ofrojë çmimin më të lartë.

PËR ÇDO INFORMACION KONTAKTONI NË :  
E-MAIL : administratorfalimenti@flybelleair.com  
lela\_cu@yahoo.com  
TEL: 00355 69 20 92 483  
OSE:  
Vizitoni faqjen zyrtare: [www.belleair.al](http://www.belleair.al)

**belleair**  
Shpk, Shoqëri në Faliment

### Njoftim për shitje me ofertë të drejtpërdrejtë

Administratori i Falimentit Arjeta Çumani njofton shpalljen për shitjen me ofertë të drejtpërdrejtë për kioskat që ndodhen pranë Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë. Kërkesë Ofertat do të pranohen deri në datën **18 Nëntor 2017 ora 13:00**. Pas vlerësimit të kërkesës ofertave tuaja, fitues do të shpallet ai subjekt që do të ofrojë çmimin më të lartë.

Për të dërguar kërkesë ofertat, si dhe secili subjekt që është i interesuar për më shumë informacion mund të dërgoj e-mail ose të kontaktoj në nre telefonit:

E-MAIL : [administratorfalimenti@flybelleair.com](mailto:administratorfalimenti@flybelleair.com)  
[lela\\_cu@yahoo.com](mailto:lela_cu@yahoo.com)  
TEL: 00355 69 20 92 483

OSE:  
Vizitoni faqjen zyrtare: [www.belleair.al](http://www.belleair.al)







14 - SPECIALE

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

SABRI DHE FETUE E TRASHEGONIE FEMIJET LAYER,RUBIE,SEFER,AVNI,MYMER LAYER E TRASHEGONIE FEMIJET VILKESON, NIKO RUBIE E TRASHEGONIE FEMIJET TOMOR, QEMAL, ZINI, ARTERA SHENIM: AVNI DHE ARJET NUK KANE MARRE ASNIJE KEST PER MUNGESJE DOK.LIGJOR, TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI AVNI KA PLOTESUAR DOK.LIGJOR ARJET DUHET TE SIELLE CERTIFIKATE PERSONALE (KOPIE ID) DHE VERETIM NR.LLOGOAR BANKARE

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

SAMI E TRASHEGONIE MYNEVERE, FIJAT VJOLLCA MIRRELA FIJAT E TRASHEGONIE SAMI, ARBEN, MELIJA, MIRRELA VJOLLCA E TRASHEGONIE AGIM, RAMPAN, ASHRI, SHKELQI, DUDIE, GJINOVEFA, LUJZA, PELLUM, FLORA SHENIM: AGIM, ARBEN, MELIJA, SAMI NUK KANE MARRE ASNIJE KEST PER MUNGESJE DOK.LIGJOR, VENKELI, DIDA I KA PLOTESUAR DOK.LIGJOR SAMI, ARBEN, AGIM DUHET TE SELLEN CERTIFIKATE PERSONALE DHE VERETIM NR.LLOGOAR, GJITHASHTU MUNGONIE CERTIFIKATA TRINGU PER FIJAT DHE VJOLLCA TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

SAMI E TRASHEGONIE MYNEVERE, FIJAT VJOLLCA MIRRELA FIJAT E TRASHEGONIE SAMI, ARBEN, MELIJA, MIRRELA VJOLLCA E TRASHEGONIE AGIM, RAMPAN, ASHRI, SHKELQI, DUDIE, GJINOVEFA, LUJZA, PELLUM, FLORA SHENIM: AGIM, ARBEN, MELIJA, SAMI NUK KANE MARRE ASNIJE KEST PER MUNGESJE DOK.LIGJOR, VENKELI, DIDA I KA PLOTESUAR DOK.LIGJOR SAMI, ARBEN, AGIM DUHET TE SELLEN CERTIFIKATE PERSONALE DHE VERETIM NR.LLOGOAR, GJITHASHTU MUNGONIE CERTIFIKATA TRINGU PER FIJAT DHE VJOLLCA TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

HYSEN E TRASHGONIE E MA HYRE HYRE E TRASHEGONIE GJYLFIZARE, HAJRIE, MIRESDIJE, DITRA DITRA E TRASHGONIE MARTA, VILLOSMAN YLU KA VDEKUR DHE PISJA E TUD DO TE NDARHET MIDIS MARTA DHE OSMAN NE KESTIN E BRADHES HAJRIE KA VDEKUR, MUNGONIE DOK.LIGJOR, CERTIFIKATE TRINGU FAMILJARE DHE DESIMI TRASHGIMTE LIGJORE TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

HYSEN E TRASHGONIE E MA HYRE HYRE E TRASHEGONIE GJYLFIZARE, HAJRIE, MIRESDIJE, DITRA DITRA E TRASHGONIE MARTA, VILLOSMAN YLU KA VDEKUR DHE PISJA E TUD DO TE NDARHET MIDIS MARTA DHE OSMAN NE KESTIN E BRADHES HAJRIE KA VDEKUR, MUNGONIE DOK.LIGJOR, CERTIFIKATE TRINGU FAMILJARE DHE DESIMI TRASHGIMTE LIGJORE TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

HYSEN E TRASHGONIE E MA HYRE HYRE E TRASHEGONIE GJYLFIZARE, HAJRIE, MIRESDIJE, DITRA DITRA E TRASHGONIE MARTA, VILLOSMAN YLU KA VDEKUR DHE PISJA E TUD DO TE NDARHET MIDIS MARTA DHE OSMAN NE KESTIN E BRADHES HAJRIE KA VDEKUR, MUNGONIE DOK.LIGJOR, CERTIFIKATE TRINGU FAMILJARE DHE DESIMI TRASHGIMTE LIGJORE TRASHGIMTARET E TIERE JANE PAGUAR PER DY KESTE DHE NUK JANE PER PAGESE TANI

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

CENE E TRASHGONIE MOTRA MEVLIE DHE VELLAI AVDYL SHENIM: MEVLIE KA MARRE DY KESTE DHE NUK ESHTË PER PAGESE TANI AVDYL NUK KA MARRE ASNIJE KEST PER MUNGESJE DOK.LIGJOR, DUHET TE SIELLE CERTIFIKATE PERSONALE (KOPIE ID) DHE VERETIM NR.LLOGOAR BANKARE

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

XHEMEL E TRASHGONIE MERZAKE (BASHESHORTAJ) DHE FEMIJET ALI, RAJMONDA, VALENTINA, DEKLE, ELLEN MERZAKE E TRASHGONIE FEMIJET YLLKE, RAJMONDA, VALENTINA, DEKLE, ELLEN

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

HAFRI E TRASHGONIE FEMIJET RUKI, ADRI, GJERGA, GJITE, BASHKIM, NUREDDIN, ASHRI, ABEN, DABIE NUREDDIN KA PROKURE PER TI PERFAQESUAR TE GJITHË PER TERHEQEN E DEMOSPËRBLIMIT

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

LODOVIK E TRASHGONIE LIN (VELLA) DHE ANGJIE (MOTRA LIN E TRASHGONIE FEMIJET BRIGJITA, NIKOLIN, EDMOND, FREDERIK, LUJG) ANGJIE E TRASHGONIE FEMIJET TONIN, MADALAZ, ZEF, VIKTOR, GJYLJANA LUJG KA PROKURE PER TI PERFAQESUAR TE GJITHË PER TERHEQEN E DEMOSPËRBLIMIT

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

ZENEL DHE DUDIE E TRASHGONIE FEMIJET SELVIE, NURCE, FERJAT, LIRI NURCE KA PROKURE PER TE GJITHË

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

ZENEL DHE DUDIE E TRASHGONIE FEMIJET SELVIE, NURCE, FERJAT, LIRI NURCE KA PROKURE PER TE GJITHË

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

IBISH E TRASHGONIE ROZA (BASHESHORTAJ) DHE FEMIJET BASHKIM, FATMIR, GJZIM SHENIM: ROZA, BASHKIM, FATMIR DO TE PAGUHEN PER KEST TE DYTE GJZIM KA PLOTESUAR DOK.LIGJOR, DHE DO TE PAGUET PER KEST TE PARE

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

GEJE E TRASHGONIE FEMIJET DUD, LLESH, DAVE, PRENG LLESH E TRASHGONIE TANO, MARIANA, DIL, GERIT SHENIM: LLESH E KA TERHEQUR VET KESTIN E PARE, TRASHGIMTARET E TJU DUHET TE SELLEN DOK.LIGJOR, CERTIFIKATE VDEKJE DHE CERTIFIKATE TRINGU FAMILJARE PER LLESH NE MENYRE QE TE

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

JANI E TRASHGONIE ALEKSANDRA (BASHESHORTAJ) DHE FEMIJET LLAZAR, PETRAQ, ALEKSANDRA E TRASHGONIE FEMIJET LLAZAR, PETRAQ, MUNGONIE CERTIFIKATA E VDEKJES SE ALEKSANDRES, TRASHGIMTARET DUHET TA SELLEN NE MENYRE QE TE BEHET PAGESA PETRAQ E TRASHGONIE FEMIJET MINA, JANO, ANDRO, ADRIANA, TE CILET I KANE DHENE AUTORIZIM ME PROKURE LLAZAR PER TERHEQEN E DEMOSPËRBLIMIT, POR NE PROKURE EMRI I ISH TE PISH SHENIM: KA MUNGONIE PER GENERALISTEN TE ISH TE DESUARI POLIKIM ME ENTIN E MIRATUAR NE VIM NE CERTIFIKATE E VDEKJES; JANI, ZOGA NE JANI ZOGA TRASHGIMTARET DUHET TE SELLEN JERE VERTETIM NGA MINISTRIA E DREPTESISE PER GENERALISTET E ISH TE DESUARIT POLIKIM

FORMULARI MBI PERKACTIMIN E TRASHEGIMTAREVE, BRETËH FAMILJAREVE TE PERKACTUAR NE LIGJ, PER PAGESEN E KESTIT TE DYTE

Shënim: Kuj dokumentacioni është i rregullt shërbimet me V, kur kase autorizuar me produkt shërbimet me P.

Table with columns: NR. DOSHES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESEA, MBEMER, EMER, ATESEA, MBEMER, DATELINA DIA, KOPIE TE LETER NJOFIT M, NUMER PERSON AL LOGOAR I BANCAR E, CERTIFI KATE VDEKJE, CERTIFI KATE TRINGU T FAMILJA R, DESIMI TRASHG I MIE, PRO KURE

HASAN E TRASHGONIE KAJME (BASHESHORTAJ) DHE FEMIJET BAURAM, DULE KAJME E TRASHGONIE FEMIJET BAURAM, DULE SHENIM: TRASHGIMTARET DUHET TE SELLEN CERTIFIKATE VDEKJE PER KAJME NE MENYRE QE TE BEHET PAGESA PER KESTIN I DYTE





## SHKRIMTARET NE DIKTATURE

**Ekskluzive/** Publikohet informacioni i Dritëro Agollit për Komitetin Qendror, lidhur me dënimet në gazetën "Drita" dhe emrat e propozuar prej tij për redaksinë e saj

# Raporti i Agollit: Për gabime ideologjike u dënuan 80% e kuadrove të gazetës "Drita"

*Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi*



Enver Hoxha me artistë dhe shkrimtarë

Nga DASHNOR KALOÇI

Pas fjalës së Enver Hoxhës mbajtur në Presidiumin Ku vendit Popullor më 15 mars të vitit 1973 dhe më pas me aparat-in e Komitetit Qendror të PPSH-së e Plenumin e V, që si objekt kryesor kishte: "Lufta ndaj shfaqjeve të huaja dhe liberalizmit në art e kulturë e ndikimi e tyre në të gjitha fushat e jetës...", gjë e cila shënoi dhe prologun e furtunës së madhe ndaj njerëzve të artit, kulturës dhe letrave shqipe me largime nga puna, ulje e shkarkime nga detyra, dëbime, internime apo dënime me burg, disa nga institucionet kulturore dhe artistike të kryeqytetit, apo organet kryesore të shtypit u përballën me mungesë kuadros, kryesisht atyre krijuese. Kjo hemorragji preku edhe organet e Lidhjes Shkrimtarëve dhe Artistëve, si p.sh. gazetën "Drita", ku rreth 80% e stafit të saj krijues, me gazetarë dhe redaktorë ishin larguar që andej "për gabime ideologjike të karakterit liberal". Gjë e cila bëhet e ditur edhe nga ky dokument arkivor që po publikojmë në këtë pjesë të librit, ku kryetari i sapoemëruar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Dritëro Agolli, (pas shkarkimit të Dhimitër Shuteriqit për liberalizëm) i kërkon sektorit përkatës të Komitetit Qendror të PPSH-së plotësimin të kuadrit të nevojshëm të gazetës "Drita" pasi, "kjo gjë e ka bërë shumë të vështirë punën e gazetës, sidomos, veprimtarinë e saj për të vënë në jetë vendimet e detyrat rëndësishme dhe urgjente që Partia ka shtruar përpara letërsisë dhe arteve, përpara vetë gazetës "Drita". Dhe në kërkesën e tij, Agolli ka bërë edhe sugjerimet përkatëse me emra konkretë për redaktorë dhe drejtues sektorësh si në gazetën në fjalë, ashtu edhe në Lidhje. Personat që u afruan aty më pas me propozimin e Agollit, zëvendësonin kolegët e tyre, që i kishin përzënë që andej me dënime të ndryshme, ku "një dorë" për largimin e tyre, apo më



Rexhep Qosja dhe Dritëro Agolli

saktë "flamurin e sulmit" e kishte mbajtur vetë Dritëro, para se të emërohej si kreu i Lidhjes! Veç të tjerash, kjo gjë bëhet e ditur edhe nga një prej mbledhjeve të gjata të zhvilluara në pranverën e vitit 1973, (gjë të cilën e kemi prekur në një kapitull të veçantë edhe të libri "Kadare në dokumentet e Palatit të Endrrave"), prej së cilës kemi shkëputur disa radhë, që po i publikojmë më poshtë në këtë shkrim.

LIDHJA E SHKRIMTARËVE  
DHE ARTISTËVE  
TË SHQIPËRISË  
TIRANË, 3.10.1973  
NR. 3 PROT.

KOMITETIT QENDROR  
TË PPSH  
SEKTORIT TË  
KUADRIT  
Tiranë

Prej më se 4 muaj, për shkak të gabimeve ideologjike të karakterit liberal, u larguan pjesa më e madhe e kuadrove të saj, rreth 80%. Deri më sot kanë ardhur në redaksi vetëm 3 kuadro dhe një stazhiere. Me gjithë përpjekjet e njëpasnjëshme të Lidhjes së Shkrimtarëve për të plotësuar të paktën 50% të organikës së vendeve vakante në gazetën "Drita", me

daksisë, sot punojnë vetëm 5 dhe një stazhiere.

Me qëllim që të mos zvarriten më tej këto çështje dhe që redaksia e gazetës "Drita" të plotësohet me redaktorë e domosdoshëm, lutemi të ndërhyhet nga ai sektor për të sjellë në këtë gazetë:

1. NDUE ZEF TOMA, punonjës në Institutin e Gjuhësisë.
2. ÇAPAJEV GJOKUTAJ, pedagog në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë.
3. PETRO DHIMITRI, redaktor në gazetën "Bashkimi".
4. SPIRO KALEMI, pedagog në Institutin e Lartë të Arteve.

Përveç këtyre, për të plotësuar sektorin e edukimit në Lidhje propozojmë të vijnë:

1. FOTAQ MALO, punonjës i Radio Gjirokastrës.

Meqenëse në Lidhje nuk është caktuar ende sekretari për muzikën, ne i parashtrijmë atij sektori mendimin tonë:

1. XHEMIL SIMIXHIU – pranë Institutit të Lartë të Arteve.

Po kështu, lidhur me studimin tonë paraqitur aparatit të Komitetit Qendror të Partisë për të krijuar sektorin e skenës dhe ekranit pranë Lidhjes, duke e shkëputur këtë nga sektori i letërsisë, për vetë specifikën e veçantë të drama-

turgjisë, skenës së teatrit dhe kinematografisë sonë, i parashtrijmë atij sektori për sekretar një nga shokët e poshtëshënuar:

1. ESAT OKTROVA, pranë Institutit të Lartë të Arteve.

2. MISTO ZOTO, pranë Institutit të Lartë të Arteve.

Për sa sipër, mbetemi në pritje.

Kryetari  
Dritëro Agolli

Shënim  
Ju dha porosi Xhemal Dinit që të studiojë kandidaturat dhe të lidhen edhe me rrethet e të vijnë propozimet e plota.

Diskutimi i Dritëro Agollit në Lidhjen e Shkrimtarëve në vitin 1973

**Kritikat dhe akuzat e Agollit ndaj Paçramit, Uruçit, Shuteriqit, Kadaresë etj.**

Ne sot jemi mbledhur të disku-







eralizmin. Të njëjtën gjë e përsëritën Ibrahim Uruçi e Dhimitër Shuteriqi. E quan Fadil Paçrami “Zërin e Popullit” konservatore. E rrëmbeu Ibrahim Uruçi dhe ia përsërit nga vetja shokut Ramiz. Ngul këmbë shoku Fadil që “Dritës” t’i lejohet polemika në “Zërin e Popullit”, hidhet Ibrahim Uruçi në sektorin e shtypit në KQ dhe kërkon polemikë në “Zërin e Popullit”.

Nuhatet se Fadil Paçrami nuk i ka qejf forcat e moshuara letrare dhe artistike. Kjo kërkesë, patjetër gjen zbatim. Vilson Kilica thërret Dalan Shapllon dhe i bën presion që ai të heqë nga referati i tij në shumë “aspekte të letërsisë dhe arteve nëpër dokumentet e partisë dhe veprës së shokut Enver”, emrat e Andrea Varfit dhe Nexhmedin Zajmit, duke e motivuar se nuk shkojnë këta shembuj. Doemos Dalani i heq. I thonë Fadil Paçramit në Durrës të heqë një copëz që nuk shkonte nga drama “Çështja e inxhinier Saimirit”, ai i heq. Pikërisht këtë copëz që heq në Durrës, ia boton Ibrahim Uruçi në “Drita”. E di Ibrahim Uruçi se shoku Fadil Paçrami i quan konservatorë ca kritikë të institucionit të Gjuhësisë, si Jorgo Bullo e ndonjë tjetër. Shkruan Jorgo artikull, e merr Ibrahim Uruçi me dorëshkrim dhe ia jep Dalanit: ‘na


e bjeri!’ Pa e botuar, Dalani refuzon. Ky refuzim vihet vath në vesh. E boton artikullin Dalani, i ndërshen nja 5-6. I Uruçi kundër Dalanit.

E shihni pra se si përputhen shumë koncepte të Fadil Paçramit me një pjesë të drejtuesve të Lidhjes. Këto koncepte përputheshin edhe me cenimin e drejtimit unik të Lidhjes nga KQ. Në fakt, drejtimi unik është thyer disa herë. Lidhja ka cenuar herëherë haptazi, në kundërshtim me orientimet e K.Q. Ajo ka dëgjuar më shumë Fadil Paçramin se K.Q. Këtë e vërtetojnë mjaft qëndrime të Ibrahim Uruçit, e ndonjëherë tjetër edhe të shokut Dhimitër. Psh., shoku Dhimitër dhe Ibrahim Uruçi e kundërshtuan haptazi komisionin e K.Q. për të parë debatin në shtypin e Lidhjes në qershor e korrik të vitit të kaluar. Kur u tha atje se “Drita” flitet se është bërë organ i Fadil Paçramit, pasi i mbivlerësuan veprat e tij, shoku Dhimitër e hodhi poshtë këtë vërejtje duke thënë se Fadil Paçrami ka merita të mëdha.

Ky ishte edhe mendimi i shokut Fadil. “Rreziku i liberalizmit është vetëm në potencë”, – thoshte shoku Dhimitër. Injëjti mendim në zyrat e “Dritës”; ditën e dytë të Festivalit të 11-të të Radio Televizionit, ra fjala për debatin. “Të mos kemi fyerje. Duhet kujdes me debatin, se e patë se ç’na ndodhi në korrik, se çfarë na punuan”, thotë shoku Dhimitër: “Ata që na e thurisin atë, po heqin shpirt”, – ia pret shoku Fadil. Pra, unë jam plotësisht i bindur se mjaft gjëra kanë qenë në kundërshtim, të hapët me orientimet e K.Q. dhe është cenuar drejtimi unik i Lidhjes, gjë që ka dëmtuar gjithë mekanizmat e organizatës, duke ngjallur dhe konfuzion në mendime nëpërmjet botimeve në “Drita”, veçanërisht, pastaj edhe në “Nëndori”.

Në “Drita” nuk zbatoheshin fare këshillimet e K.Q. Kryeredaktori i saj nuk i shpinte orientimet të redaktorët; edhe kur i shpinte, i shpinte në formë ankese dhe redaktorët bërtisnin “t’ia përplasje në fytyrë, në s’kemi fyer njeri”. Kujt t’ia përplasje në fytyrë, K.Q?! Ëshhtë fjala për artikullin e Pandeli Koçit, lidhur me polemikën e Razi Brahimit. Ky konfuzion prej avangardizmi u nxit edhe prej kuadrit të paformuar të shtypit, kuadër që s’ka mendime të vetat, po bën ç’t’i thotë Ibrahim Uruçi apo ndonjë tjetër. Parimi i zgjedhjes së kuadrit në shtyp, veçanërisht në “Drita”, u bë krejt në parime subjektivist. Në dy drejtime kishte subjektivizëm; të sjellim njëzëz që t’i nënshtrojmë, të jenë të bindur, goftë dhe në origjinë, të sjellim ata që na kanë lavdëruar Fadil Paçramin dhe veprën e Ismail Kadaresë.

Kështu, Moikom Zeqo u mor se kish botuar një apo dy artikuj të Ismail Kadaresë. Donika Feshiti u mor se kishte bërë një diplomë për dramën e Fadil Paçramit, nga “Drita” u hoqën të dy komunistët, Andon Kuqali e Thoma Frashëri. Përbërjes ideopolitike të kuadrit as i vënë rëndësi. Janë marrë disa njëzëz që u ka dalë emri në procese gjyqësore, si Roland Gjoza, ose që kanë përbërje të keqe, si Vasil Melo, Gjergj Zheji etj. Gjergj Zheji thotë në plenumin e kritikës se, “duhet të kthejmë kokën nga kritika perëndimore”. Vasil Melo thotë se “fyejmë për KQ”. Kështu, njerëzit që vijnë, as shtrohen në organizatën bazë të partisë, pra është një liberalizëm i theksuar edhe në këto punët e kuadrit.



tojmë për fjalimin e fundit të shokut Enver “Si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi imperialist revizionist i vendit tonë dhe efekti i presionit të tij mbi ne”.

Përgjegjësi të madhe veçanërisht mbajnë shoku Dhimitër Shuteriqi, si kryetar; shoku Vilson Kilica, si sekretar i përgjithshëm; shoku Ibrahim Uruçi, si kryeredaktor i “Dritës” dhe shoqja Hamide Stringa, si sekretare për muzikën. Nuk dua t’i fyej, unë kam respekt për ta, por ata kanë pasur një bekim dhe një adhurim të madh për Fadil Paçramin. Konceptet e tij të drejta avangardiste dhe nihiliste, antishkencore në kuptimin e traditës, në kuptimin e konservatorizmit dhe të liberalizmit, në kuptimin e konfondimit të traditës.

Me konservatorizmin dhe të novatorizmit me liberalizimin kanë gjetur përkrahjen e tyre. Fadil Paçrami çdo ditë rrinte kokë më kokë me të, vinte në klub, ngjitej lart në zyrë, dilte nga zyrat

në rrugë, nisej nga rruga në vende turistike. Në këto takime rriheshin mendimet, përpunohej një ide, e cila pastaj përhapej me gojë dhe depërtonte edhe në shtyp. Ish-te formuar një farë klani, që binte në sy nga të gjithë shkrimtarët dhe artistët. Kudo ku ishte shoku Fadil, patjetër do të ishte Ibrahim Uruçi. Kur mungonte Ibrahim Uruçi, patjetër do të ishte Vilson Kilica. Gazeta “Drita” ishte bërë e tijja, ai do ta drejtonte. Hidhej një mendim me gojë, ai do të gjente reflektim. Natyrisht, shkalla e bashkëpunimit të këtyre shokëve me Fadil Paçramin nuk ishte njëloj.

Shoku Ibrahim Uruçi ishte më afër nga të gjithë, pastaj vinin shoku Vilson dhe shoku Dhimitër. Shikojeni se si përputhen mendimet, u shkrua një artikull për plenumin e kritikës, e shkruan unë dhe Agim Shehu, pa emra. Shoku Fadil thotë se pse e kishin nënvlerësuar konservatorizmin dhe kishin theksuar më shumë lib-



## SHFAQJA

# Incesti dhe mëmësia, çfarë ndodh në shfaqjen e Ema Andreas

Josif Papagjoni

Teatri bashkëkohës në botë por dhe në Shqipëri, së paku shfaq sot tri prirje kryesore: 1) ruajtja e një formati klasik, të traditës më të mirë teatrore e sprovuar nga koha, që mund ta quajmë "teatri i oborrit", "teatri elitari", i një pakice njerëzish që kënaqen me idetë, mendimet e thella, lojën e mendjes, filozofimin, konfliktet sociale dhe ato që përthellohen në psiken e traumatizuar të njeriut përballë kimit, vdekjes, dashurive të pamundura, lakmisë shkatërruese të pushtetit, parasë, egos që s'është e kërkon sundim etj., 2) teatri demokratik i përkushtuar, më së shumti, për masat e gjera të popullit, ku luhet e teprohet me banalitetin, gjendjet sentimentale dhe spekulative, me argëtimin si të tillë, falë një thjeshtësie që shkon shpesh në skaj si në ligjërimin dramatik, ashtu edhe në aktrim, regji, skenografi, çka shprehjet e tyre, kërkimin për kode e gjuhë të re, paradoksin dhe shpesh shkeljen e "ligjeve të shenja" të teatrit, pasuar me sfidën ndaj tabuve, kokëkrisjen etj. Përkishtë në këtë hulli të fundit epohej me tërësi gjithë koncepti regjisorial i Dino Mustafiqit dhe aktrimit i Ema Andreas dhe Matia Lulapas në shfaqjen "Nëna dhe fëmija", e autorit norvegjez Jon Fosse....

Me kritikun Miho Gjini shkoka dhe e pashë shfaqjen, e cila jepej në një godinë dy katëshe, dikur studio skulptorësh, sot e kthyer në një sallë polifunktionale, me termat e sotëm "multimediale", e quajtur habitshëm "Tulla", diçka komike, si e vjetër, ku pahu i ardhur nga eksperimenti të kujton disi edhe dadaistët e të tjerë sosh që e përshfaqnin dhe e gatishnin artin e tyre shpesh nëpër ngrehina të braktitura si refuzim ndaj lukstit, rehatis dhe "klasikes". Në mes të sallës ishte çelur një udhë mbuluar me linoletum të bardhë, ku spikasnin gjithandej ca zhgarravina, njoolla të zeza, shenjë e rrëmujës, e kaosit, e çoroditjes, e inatit. Me sa duket dora e nënkuptuar nga ato zhgarravina fëmijërore ishte teje nveroze si vetë subjekti që na rrefehet. Në mes të udhës-ulluk, ku lëvizin dy aktorët e dramës, Ema Andrea si nënë dhe Matia Lulapa si biri i saj, ka një "paralele", ku të dy, herë pas here, hidhen e rrotullohen si në një tra ekuilibri. Kjo fizikulturë e përsëritur duket se pohan, së paku, dy ide: nevojën e ekuilibrit në shtjellën e një konflikti mitik nënë-bir, i cili vëdjerrtet dhe shkon thuasje në

prag të incestit tanimë si një marrëdhënie e degraduar dhe, e dyta, një farë konflikti fizik e karshillëk njëri përkundër tjetrit, shkakuar nga historia traumatike ku nëna braktis birin-fëmijë, ndërsa biri i burrëruar ndjehet i frustruar nga mungesa e dashurisë së nënës teksa është rritur dhe ka dalë në jetë. Janë të dy të vetmuar, të braktisur, të stresuar. Ankthi ekzistencial i jetës, frustrimet e saj mbarë e prapë, vrapit i çmendur në ikamendjet raskapitëse, drejt një karriere, a një mirëgenieje a lirisë së munguar e të shumëdëshiruar, krijon atë boshin e frikshëm që vjen kur ti bën "llogaritë": ku isha, çfarë bëra, a e gjeta paqen, a e preka lumturinë? Dhe përgjigja është: "Jo, o njeri, vrapit i çmendur s'te ka lënë kohë dhe hapësirë, vrapit si ena bosh, pa ahur, vrapit që të cilvilit dhe shpirtin ta zbrast..." Kemi aq shumë nevojë për tjetrin, sepse pa "tjetrin" nuk jemi dot vetvetja, pa "tjetrin" ne e humbasim përfundimisht vetveten....

Afërmendsh se është një shfaqje që rrugëton në hapësirën e eksperimentit ose, thënë më drejt, të një teatri që aplikon kode dhe shënime postmoderne, ku, siç thamë, vendi i veprimit skenik vendoset në mes të sallës, spektatorët rrinë rreth e rreth këtij vendi, diçka të 50-80 vetë, me aq sa i bënte shfaqjet e tij dhe regjisori i famshëm Jerzhi Grotovski ose italiani Luka Ronkone, duke realizuar atë që quhet "kontakt njerëzor", pra një zbritje mundësisht e epërme e nivelit të komunikimit, sy për sy, midis aktorit dhe spektatorit, ku gënjeshtra më e vogël, ku tjetërsimi dhe "maska" aktoriale, e domosdoshme dhe aktive në skenën e ngurrur të një teatri klasik, prishin shumë punë, rrethojnë stilin dhe jo vetëm që bie në sy dhe aktori mbejt zbuluar cullak, por ato e tëhuajnë vetë këtë lidhje dhe komunikim. Teksa e shijua aktrimin e Emës dhe Matia Lulapas, kishte çaste që ata vërtet humbitnin në përpëllitjet e tyre shpirtërore, të mllafet dhe dufet e dy qenieve mbushur me zemërim, që mëmësia dhe gjiri i qumështit i kishte lidhur në zanafillë kur nis e bulbon dashuria e amshueshme e nënës ndaj birit dhe anasjelltas. Dhe vija re se qenë të vërtetë, se rrekeshin ta "përsërdëzonin" marrëdhënien e tyre të vështirë, komplekse, mbushur me kundërtënie e një terr ndërdijesor që përziente e shpesh ngatërronte filllet totalogjike të qenies nënë-bir, kur gati-gati mëria, hakmarrja, zemërimi, po aq dashuria e munguar dhe e keqkuptuar, përcëmbim dhe neveria, gjer dhe tundimi, i shpinte ata në udhën pa krye, në qorrsokakun fatal ku rreziku i konvertimit të mëmësisë në tundim na përplaset sysh. Kjo vinte më shumë nga ideja regjisoriale, rrjedhimisht edhe nga aktrimi me orientim që ai kishte, se sa nga autori, i cili, sipas meje, me aq sa e perceptova tek-



Ema Andrea dhe Matia Lulapa

*"Në këtë marrëdhënie nëna nuk shihet kurrë si femra që tundon ende dhe biri jo me domosdo si mashkulli i munguar"*

stin, e vendoste oprinë e tij pikërisht në shkaqet e tronditjes së marrëdhënies dramatike nënë-bir: braktisja e fëmijës në castin kur ai duhet ta tejkalojë dashurinë e mishit dhe qumështit të gjirit që vjen nga mëmësia, për të mbërritur në një tjetër stad, tashmë moral, ku dashuria e nënës ndaj birit dhe birit ndaj nënës sublimohen në një nivel thuasje të shenjtëruar.

Kisha dëgjuar tej e tëhu se shfaqja kishte elemente të incestit. Kjo lloj letërsie, më shumë e pëlqyer nëpër filma, ka një farë spekulacioni në vetvete, kinsë për të sfiduar tabutë dhe për të prekur gjësende që quhen ende të "shenjta" dhe "absolute". Asgjë të keqe s'ka që edhe tema të tilla të mprehta të vijjnë përpara syve të publikut shqiptar, paçka se në përgjithësi ai është tejet konservator dhe nuk ia ka ënda trajtesa të tilla, sado në rrafsh psikanalitike qofshin. Kombe të tjerë më të emancipuar kanë kohë që i sjellin subjekte të tilla, ku rrinëzohet traumat dhe komplekset e njeriut, ndër to edhe seksualet, nga tabuzimi dhe klish-



etë e ngurta morale etj. Unë jam që edhe argumente kësilloj të vijmë në teatër e të shfaqen publikisht pasi dukuri të tilla gjenden brenda vetë qenies. Unë nuk jam kur këto kthehen në vetëgjëllim. Nuk më tronditi derdhja e dy shisheve me qumësht mbi gjinjët e zbuluar të aktore Ema Andrea (i lumtë për guximim e saj në voli të artit dhe shembjes së tabuve edhe në aktrim). Unë e dekodova atë pikërisht në sfidën që kjo grua kishte ndaj të birit dhe "harresës" që ai kishte pasur ndaj fatit të saj, teksa dikur, ende i vockël, e lakmonte atë burim jetik, qumështin mëmësor dhe luante me gjinjët. Bukur! Gjijnjtë dikur ishin lodra dhe burim kënaqësie mishtore, por jo ende seksuale. Gjijnjtë e gruas bëhen seksuale, kur fëmija bëhet burrë, mashkull. Prandaj nëna e Emës ia lyej gjoksin të birit me një lëng të kuq, që gjithkush e konoton si gjak, pra simbolika mashkullore. Qumësht dhe gjak, burrë dhe grua. Nëna kërkon që ai të bëhet burrë. Po deri ku?

Unë them se regjisori skenën alegorike të gjinjeve dhe të qumështit e ka "vizionuar" gjeëgjësisht një ideje të pohuar nga vetë personazhi i nënës, si kundërvënie ndaj të birit që e kishte harruar, në mos mohuar. Në fakt të dy janë të fajshëm, të dy kanë mohuar e braktisur njëri-tjetrin dhe apologia e autorit, me sa perceptova unë, ishte domosdoja e një vitalizimi të marrëdhënies eterne dhe mitike nënë-bir, kur përfundimisht ne shpëputemi nga prania dhe nevojja fizike dhe riformatohe mi në një nivel tjetër marrëdhënies, tashmë fund e krye shpirtëror e moral. Në këtë marrëdhënie nëna nuk shihet kurrë si

femra që tundon ende dhe biri jo me domosdo si mashkulli i munguar, por në një tjetër nivel, formë dhe brendi psikike. Ky raport kaq i brishtë dhe lehtësisht i konvertueshëm drejt incestit vjen në shfaqje jo si realitet i ndodhur, por si rrezik dhe mundësi gabimi, prandaj dhe marrëdhënia nënë-bir midis dy aktorëve përvijohet pikërisht në këtë kampanë alarmi, të ky shilarës rreziku dhe frike për t'i dhënë raportit të munguar përhirimin dhe shenjtërimin që ai ka në vetvete. Unë dua të kujtoj, bie fjala, se në tragjedinë "Orestit" të Eskilit, Klitenmestra, nëna e tij që kishte vrrarë burrin e vet dhe babanë e Orestit, Agamemnonin si mbret dhe hero, teksa djali kërkon që ta vrasë, ajo i nxjerr gjirin mëmësor duke i kujtuar se ishte ushayer nga qumështi i saj. Por Orestit ia ngul thikën pikërisht mu në gj. Gjiri i Klitenmestrës ishte tashmë i përdhosur, prandaj dhe vrasja që ai i bëri të emës u legitimua si e drejtë e rekomanduar dhe e lejuar nga hyjnitë. Në dramë nuk kemi vrasje. Faji duket se tejkalohet në formën e një katarise për t'i konceptuar ndryshe marrëdhënien nënë-bir. Jo gjiri dhe qumështi i nënës kamë të drejtën e sundimit të njërit ndaj tjetrit, ose atë të refuzimit dhe neverisë, por nivelet e reja shpirtërore dhe humane që pranojnë përgjegjësinë reciproke, kur dashuria konvertohet për fat të keq në mëri, hakmarrje, tjetërsim, gjer dhe në tundim. Ky raport kaq i ndërlikuar, në fije të perit, erdhi falë një loje plot vrulle nga të dy aktorët, Ema me përvojën e saj, zërin imponues, klithmë, plastikën e zhdërvjellët, një rreptësi e cinizëm që vetëshprehte e buron nga gjithë qenia e saj aktoriale dhe, nga ana tjetër, aktori i ri Matia Lulapa, i cili pati një hapësirë të gjërë të lëvizjes së karakterit të tij, nga tonimet e ironisë, pezmit, zemërimit dhe gjer të shpërthimit dhe flukset dramatike vërtetë të bukura, siç që përplasia që i bën të emës për moskujdesin e saj, për braktisjen që i kishte bërë në moshën delikate të rritjes etj. Mjafton ky monolog tij për t'u bindur se ske-na jonë ka fituar një aktor të ri me potenciale të dëshirueshme, i cili ka nevojë nesër për më shumë shans dhe një dorë të kujdesshme.

Përsos synimit dhe konceptit regjisorial dhe atij aktorial për të rindërtuar një marrëdhënie sa më të afërt me publikun, përsos "shembjes" së murit të katërt, afërinë e pikës së vështrimit të spektatorit kundruall aktorit ku shikant shumëçka, syri dhe çdo grimasë, ku ndjehet frymëmarrja e tyre, puls i shpirtit, sikundër është gjakuar edhe me dy aktorët në fjalë, po aq duhet vlerësuar, nga ana tjetër, edhe shumëplanësia e lojës, jo thjesht interpretimi i fjalës, por edhe plastika, akrobacia, sidomos kënga (te Ema Andrea), duke e përplotësuar në tërësi aktrimin.



SHFAQJA

Anna Kove\*

# Besnik Mustafaj: Dua të vdes për një dashuri të vërtetë

Besnik Mustafaj mund të mburret lirshëm me këtë vëllim të tijin poetik, të krenohet me stilin e tij, për marrëdhënien e bukur që poezia e këtij vëllimi krijon me lexuesin, me përdorimin lakonik të rrëfimit ndiesor, për krijimin e veçantë të verbit poetik, për trajtimin krejt delikat të gjuhës, ashtu siç e trajton edhe të dashurën nëpër vargje. Poezi për zemrën – ja, kështu i thashë vetes tek lexoja gjatë redaktimit të librit “Biri i Adamit”. Sepse jo vetëm mendja po ushqehet bukur estetikisht, por edhe zemra ndiqte ritmet e leximit mes ndryshimit të ritmeve të rrahjes. Madje, dhe sytë m'u përloën disa herë:

**“ZBULIMI I BURRIT” – DHE GJAKU IM NËN LËKURË**

“Atëherë Jakobit puti Rakelën, ngriti zërin dhe qau”. Zanafilla 29/11.

Libri i Zanafilës nis me historinë e një dashurie, atë të burrit dhe gruas së parë; dhe ashtu në çdo përjetim dashurie, ne ndihemi në një lumturi drithëruese e të papërshtuar, si dy njerëzit e parë. Ja, pra se si “Zbulimi i burrit” nuk është vetëm zbulimi i hershën i Adamit, i Jakobit, i poetit, por edhe Lexuesit që di ta lexojë në mënyrë gjithëshqisore këtë poezi.

Lirika e poetit mbart këtu si emocionin e të vetëshprehurit të zërit, ashtu edhe të trupit. Instinktet njerëzore dhe erosi luajnë aq butësisht, sa jo vetëm poeti nuk mund ta ndjekë lojën e zanafilës krejt në distancë, por të sinkronizohet duke u bërë po aq i brishtë sa heroi lirik, por nën ndikimin e pashmangshëm të brishtësisë së vargjeve, po aq i brishtë bëhet edhe lexuesi. Këto vargje që na vizatojnë situata erotike të ngrohta, e bëjnë lexuesin të jetë krejtësisht i përfshirë në përjetimet vetanake të

autorit. Pronori i përdorur këtu e bën lehtësisht të identifikueshëm lexuesin me burrin e parë, me Adamin, me Jakobin, me poetin, me vetveten.

**VDEKJA - OSE FJALA MË E BUKUR PËR DASHURINË E PAKOHË**


Nga poezitë e hershme të vëllimit, që datojnë në vitin 1987, e deri tek ato të vitit 2017, gjejmë tinguj vargësh të gëzuara, por edhe të trishtuara, melankolike, provokuese, mohuese të realitetit e ndonjëherë pajtuese me të, madje pajtuese edhe me vetë vdekjen, së cilës autori i bën një trajtim poetik krejtësisht të veçantë dhe ndonjëherë po aq të kujdesshëm sa edhe me vetë dashurisë.

Të thashë, unë hyra padashur në lojë, Po të humbisja, me ç'kisha lënë ti tek unë Do të zbukurohej vdekja aq shumë Sa lehtësisht do të futej ndër njerëz, si joshje e ëmbël.

(Nga Poezia “Qymyri i çuditshëm”)

Ajo që nuk ndryshon në këto poezi pa dyshim është gjeografia e dashurisë së poetit: për gruan, të dashurën, vendlindjen, për Hanën,

Vëllimi poetik “Biri i Adamit”, vargjet nga viti 1987



për natyrën; dashuria për dashurinë pa fillim e pa fund/si në përrallë; ajo ka zemrën e autorit, kudo të jetë ai, në Paris, në Tiranë, në Prishtinë, në Nju Jork, në Torino. E ç'janë 30 vjet për dashurinë në poezi (mosha e poezive të librit)? Asgjë s'janë. Kur e dimë se ajo është e pavdekshme.

Unë dua të vdes për një dashuri të vërtetë, që e kam në ëndrra dhe e kam në zhgëndrra, mësova prej saj lojën e deljes së trupit dhe të shpirtit, me të dhe pa të, krahet i kam përherë të harkuar në një përqafim të pafund. Unë duhet të vdes që ta mbroj, por nuk vdes dot,

kam frikë. Kush do të më ndëshkojë për frikën, kur frikacakët nuk ndëshkohen?

(Nga poezia “Dell antiheroi”) Libri është i ndarë në tri cikle. 1. Zbulimi i burrit (me 25 poezi); 2. Jashtë orbitës (23 poezi); 3. Plagë në përftyrim (17 poezi). Edhe pse poezitë rrokin realitete ndiesore 30-vjeçare, sipas vetë shënimeve të viteve që autori ka vënë përfund tyre, këtu konceptet kohore janë të gjithëshme, njësoj si fjala “nesër” në poezinë: “Nevojë për pak dashuri”

**“BIRI ADAMIT” – FUNDI VJEN KUR HARROHET FILLIMI**

Poezitë e Besnik Mustafajt nuk janë të rënduara me absurd dhe as me metafora që kërkojnë strukturime mentale të zbërthimit të tyre, por ato janë lehtësisht të kuptueshme, natyrisht sepse Besnik Mustafaj është edhe një prozator i shkëlqyer, ndaj edhe di ta ruajë magjishëm lexueshmërinë e vargjeve të tij..., ai është i vetëdijshëm se poezitë janë mënyra më e bukur për të shprehur ndjenjat. Aty fshihen emocionet e pastra. Kjo e kthen leximin e këtij vëllimi në një kënaqësi të pakrahshueshme. Në vëllimin poetik “Biri i Adamit” fjalët kanë një fuqi ndikuese të pabesueshme. Autori luan me gjuhën me lehtësi dhe ne përftojmë gjatë leximit vërtet kënaqësi të madhe. Lexon dhe përpin varg pas vargu, strofë pas strofë dhe kërkon pastaj poezi pas poezie dhe shumë më shumë nga përvojat emocionale të shkruarit, që të mund të përthesh a transkriptosh në përvoja të emocioneve vetanake. Po më pas? Me tepër e shumë më tepër: Dhe është absolutisht e nevojshme që t'i përgjigemi kësaj thirrjeje kumbuese që na i “Biri i Adamit”: “Sa nuk ka dhënë krejt shpirt fjalë/Fundi vjen kur harrohet fillimi!” \*Poete

Nga Fatmira Nikolli

# Stenda më origjinale e panairit dhe mesazhi i saj

Është stenda më origjinale e panairit, më “varfra” në shpenzime dhe më e vjera në dije. Mban emrin e një dijetari të madh, që qëqin në një derë të parë gjirokastrite, njerëzit njeriut që çeli rrugë të reja të studimeve të shqipes, duke i kthyer dyert e mbyllura të albanologjisë në porta të mëdha të dijeve dhe autoritetit shkencor, që krahasohej tanimë lirish me katedrat simotra në vende të tjera.

Stenda është ndërtuar me lëndë druri gratis, paleta. Në hyrje të stendës qëndrojnë dy bimë papirusi të kultivuara enkas për ditë takimesh si këto! Bëhet fjalë për Shtëpinë Botuese “Çabej”, që zë një hapësirë modeste në metra katrorë, në “periferinë” e panairit, në kat të dytë, por aq sa e mënjanojë dashur, aq feks në madhësinë e modestisë së saj, me ngjyra vjeshite. Stenda duket sikur ndjek gjurmët e vetë Çabejt, që në të gjallë të vetë, madhëstia e kishte të thjeshtësia e urtësia, pa



dashur asnjëherë të dilte në radhë të parë. Njësoj si ai, mesazhet i jep përmes punës, si murgjit e kahershëm, që ashtu në izolim lanë pas botime e studime madhore, pa dashur të merrnin pjesë në salltanete e shkëlqime të rrejtshme që shuhen me ndriçimin fals.

Anna Shkreli, nga Shtëpia Botuese “Çabej” që drejtohet nga e bija e dijetarit, thotë se këtë vit kemi dashur ta shohim stendën e

“Çabej” si një hapësirë komunikimi me lexuesin për të shprehur mesazhin tonë mbi vlerën e riciklimit dhe ripërdorjes. “Gjithashtu kjo stendë është dhe një qëndrim, jo vetëm ndaj gmimeve të panairit në Tiranë që janë në stratosferë, por edhe ndaj monopolizuesve të tregut libror, të cilët harxhojnë miliona në pode, lede dhe sensacione. Për hir të këtij misioni, kemi vendosur të ndërtojmë një

stendë me paleta të ricikluara dhe me 0 shpenzim”, thotë Shkreli. Shton se është një punë e bërë prej tyre, me

dorë, orë pas ore.

“Për të na mbështetur në idenë tonë do ta vlerësonim tej mase sikur të vinit qoftë dhe vetëm për të na përshëndetur, minimalisht do merrni një trëndafil”, thotë ajo.

Në fakt, veç stendës, “Çabej” ka gjithë punën që la pas Çabej, për të cilën kemi nevojë ditë pas dite, janë vepra të abanistit Eqrem Çabej, botuar në gjermanin “Excipere” ku përmendim “Hyrje në indoeuropianistikë”, “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, “Fjalor i gjuhës shqipe”, “Fonetikë historike e gjuhës

shqipe”, “Elementë të gjuhësisë e të literaturës shqipe”, “Shumësi i singularizuar”, “Diana dhe zana - Studime kulturhistorike”, “Në botën e arbëreshëve të Italisë”, etj. Janë po ashtu edhe gjerdanët “Kostelacione”, që përfshijn pjalmin e letërsisë artistike, gjerdani “Lampa magjike” që përfshijn krijimet e tregimtarëve më në zë nga bota të librave për fëmijë dhe gjerdani “Verba Mundi”, që përfshijn eseistikë dhe vepra me karakter studiomor nga disiplina të ndryshme.

Nga botimet e reja përmendim “Matilda” nga Roald Dahl përkthyer nga Beti Njuma, “Fjalë për fjalë” (Eksplorime nga hapësirat e shqipes) nga Ardian Vehbiu (botim për të cilin Vehbiu thotë se i detyrohet Çabejt për shumë nga çfarë ka mësuar, në vite, për gjuhën shqipe, gjuhësinë historike, albanologjinë dhe metodën e kërkimit shkencor në fushën tonë të dijeve), një tirazh i ri i “Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe” të Gustav Meyer, novela “ANNA, SOROR...” nga autorja e jash-tëzakonshme frënge Marguerite YOURCENAR, sjellë në shqip nga Brikena Çabej, “Kujtime 1939-44” nga Mustafa Grebllëshi, “Butrinti” nga Luigj Maria Ugolini, e jo vetëm.

Opinion i Ditës

# Kurrikula dhe injoranca e ish-ministres teknike

Prof. asc. dr. Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

... kontekst, ajo konstatoi: "Fatkeqësisht reforma kurrikulare, e huazuar, e ka vendosur arsimin parauniversitar në një sfidë të vështirë dhe të pamundur - përballja me deformimin. E aplikuar në një model "alla shqiptar" ajo ka dëmtuar arsimin bazë. Arsimiti parauniversitar, arsimiti bazë, i cili përbën thelbin e formimit dhe të zhvillimit të individit, për interesa të ngushtë partiakë e kredo politike është në një kaos demagogjik, duke cenuar thelbin e tij". Për të mbështetur këtë konstatim, ajo shtjellon këto ide kryesore: A) MAS-i hodhi poshtë draft kurrikulën e hartuar në vitin 2013 dhe aplikoi një kurrikul të huazuar nga Kosova". B) Kjo kurrikul ishte e panjohur për mësuesit. Mësuesit janë të patrajnuar për këtë model. C) Përdorimi i teknologjisë në shkollë është i kufizuar. D) Fondet nga buxheti i shtetit për arsimin janë ulur; shkolla nuk ka buxhet për të përmbushur detyrimet e saj.

Sa i qasen të vërtetës dhe mundësisë të shoqërisë shqiptare dhe a janë të mbështetura në fakte dhe të dhëna domethënëse konkluzionet e mësipërme?

A. Model kurrikular i huazuar. Është fakt që reformimi i kurrikulës së APU-së është mbështetur në kurrikulën zyrtare që po zbatohet në Kosovë. Kjo, për dy arsye thelbësore. E para, për të jetësuar direktivën e çnuar të qeverisë shqiptare për unifikimin e sistemeve arsimore të dy vendeve. E dyta, sepse kurrikula i ri i Kosovës jetëson ndryshimet rrënjësore që po zhvillohen, kudo në botë, prej fillimit të këtij shekulli. Ndryshime këto që konceptohen si "thyerje" të kornizave tradicionale në rrafshet epistemologjik, teorik dhe teknik. Zhvendosja nga frymëzimi bijehjviorist drejt konstruktivizmit, socio-konstruktivizmit dhe kognitivizmit është një prej tyre. Konceptet e reja rreth kuptimeve kyçe (p.sh., çfarë janë dija/njohuria, si zhvillohen, si përdoren, për çfarë shërbejnë, kush i zotëron e zbaton ato? etj.); kalimi nga pedagogjia e objektiveve në pedagogjinë e integritimit; shndërrimi i mësimdhënies transmetuese në nxënien bashkëpunuese; ndërtimi i kuptimit të ri për nxënien, e dallueshme nga nxënia e përmbajtjeve disiplinore të dekontekstualizuara etj., janë shembuj të tjerë të thyerjes së kornizave. Reformata që kombinonjë "thyerje" të tilla janë komplekse dhe përfshijnë rregullime madhore në legjislacion, në kurrikulën zyrtare, apo në praktikën shkollore (kurrikula e zbatuar dhe ajo e përvetësuar). Modeli kurrikular i përzgjedhur bazohet në prurjet e reja të shkencave të nxënies, sipas të cilave mendjet nuk janë të afta vetëm të mbushen, por dhe të zgjerohen; se burimet e informacionit jashtë kontekstit shkollor janë më të rëndësishme se përmbajtjet e programeve mësimore; se krahas të veçantave të çdo fushe të nxënies, ekzistojnë mjaft elemente kryesore që u përkasin të gjitha fushave, kuptimi dhe përdorimi i të cilave ndikon procesin reformues.



Për ta thënë ndryshe, nëse të draft kurrikula e vitit 2013 nxënia bazohet të dijet lëndore dhe të mësuesi që e transmetonte atë, sot, kurrikula e re me nxënies në qendër, siguron nxënien që aftëson të njohësh, të dish të bësh si duhet dhe të shpjegosh përse e bëre ashtu. Është ky argumenti themelor që zhvlerësoi produktet e draftit të kurrikulës që përgatiti Ministria e Arsimit, në periudhën 2010-2013. [Për më shumë, lexuesi i interesuar mund të informohet te: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/01/reforma-kurrikulare-dhe-kerkimi-arsimor/>; <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/03/24/reforma-anglo-saksone-e-ministrit-taf-aj/>].

Në optikën bashkëkohore, reformat kurrikulare orientohen nga shndërrimet e shoqërive të sotme dhe evolucionin i dijeve që janë madhështore dhe pëshqjellonë vazhdimisht përmbajtjet e nxënies në shkolla. Ndaj, për të parë tablonë arsimore, ne kemi nevojë për metafora të reja - për lente të reja - të dallueshme nga ato të dekadave të shkuara apo ato partiakë. Të tilla lente të reja duket i mungojnë ish-ministres teknike. Ndaj, ajo nuk arrin të kuptojë që sistemet arsimore janë sisteme komplekse dhe tejet konservatore, nga vetë natyra, të cilët nuk mund t'i drejtojmë me manovrimet të shpejta dhe të sakta, si të ishin makina garash. Ajo duket nuk e di që edhe kurrikulës tradicionale të konceptuar sipas pedagogjisë me objektiva, lu desh një shekull i tërë për t'u zhvilluar dhe përsosur. Ajo duket nuk e di që, në Kanada, reforma kurrikulare bazuar në kompetenca, ka filluar në vitin 2000. Dhe, që nga ajo kohë, asaj i janë bërë mjaft ndryshime, për të lehtësuar zbatimin e kuptimeve të reja dhe përdorimin e burimeve të nevojshme që përdorin mësuesit dhe nxëniesit në procesin e nxënies. Kujtojmë, gjithashtu, përpjekjet e nisura që në vitin 2005, në Francë, për përsosjen e kurrikulës që zhvillon kompetencat (Le socle commun des connaissances et des compétences) Ndaj, është utopi të kërkojë që kurrikula e re, e bazuar mbi idetë revolucionare për mendjen, dijen, nxënien, inteligjencën etj., të mund të përvetësohet menjëherë. Çka, gjithsesi, nuk përjashton aspak përpjekjet sistematike të institucioneve, specialistëve dhe

mësuesve për të përmirësuar çdo ditë njohuritë dhe kompetencat e tyre profesionale.

Ndërkaq, nuk është e vërtetë që kurrikula e Kosovës është ndërtuar sipas modelit skocez, sikundër pohon znj. ish-ministre. Ajo është konceptuar dhe mbështetur nga ekspertë të BE-së dhe të UNESKOS-s. Duke qenë, njëherazi, e ngjashme me kurrikulat e të gjitha vendeve të BE-së, Amerikës së Veriut e më gjerë. Si përfundim: Gjithë sa pohon ish-ministria teknike në kritikën e saj për pikën A dëshmon, në rastin më të mirë, padije të plotë.

B. Kurrikula është e panjohur nga mësuesit, sepse ata janë të patrajnuar. I përgjithësuar kësisoj, ky është një pohim i rremë. Është fakt që ka mësues të shumtë që nuk kanë arritur të kuptojnë sa e si duhet ndryshimet e sjella nga kurrikula e re. Fillimisht, këtu ndikon vështirësia që përshkruan në pikën A. Kësaj i shtohen investimet e gabuara në vite në sistemin arsimor nga qeveritë e radhës. Përmendim, p.sh., sistemin e korruptuar të trajnimit nga agjencitë ndryshme (i njohur ndryshe edhe si shtitlerja e certifikatave) apo punësimin e 1984 mësuesve pa arsim përkatës dhe 2065 mësues jashtë profilin. Nga ana tjetër, në funksion të përvetësimit të elementeve të brendisë, strukturës dhe të formës së kurrikulës së re kanë qenë 400 tryeza diskutimi, 5 konferenca kombëtare për reformat kurrikulare dhe 80 programe të reja, të bazuara në kompetencat kyçe europiane, çka po lehtëson ngarkesën mësimore për rreth 400 mijë nxënës. Për herë të parë në Shqipëri, kurrikula u pilotua në 26 shkolla të vendit, përpara se të zbatohet në sistemin dhe, vetëm në 2015-2016, u trajnuan 27.258 mësues dhe drejtues. Këto fakte flasin vetë.

Kompetencat e pamjaftueshme profesionale të mjaft mësuesve janë kushtëzuar fort edhe nga shpërpjesëtimet që kanë ekzistuar ndërmjet katër sistemeve, që vitet e tranzicionit vetëm i thelluan: 1) formimi fillestar i mësuesit, 2) punësimi dhe promovimi, 3) zhvillimi profesional i vazhduar, 4) vlerësimi i performancës. Në gjendjen siç ishin, këtyre sistemeve, u mungonte bazamenti teorik, koherenca dhe mbështetja në përvoja të mira botërore. Ndaj, re-

formimi i tyre ka nisur me ndërtimin e politikës së re, të dakordësuar edhe me aktorë të tjerë të rëndësishëm, politikë arsimore që orientohet, si kudo në botë, nga standardet profesionale të mësuesisë (të përmbajtjes dhe të performancës).

C. Përdorimi i teknologjisë në shkollë është i kufizuar. Ky është konstatim pjesërisht i vërtetë. Dhe, nëse shumë nga shkollat tona nuk kanë arritur të bëjnë funksionale përdorimin e teknologjisë të informimit dhe të komunikimit (TIK), shkaqet duhen kërkuar në mbrapshtitë e periudhës 2006-2013. Strategjia e zbatuar dhe financimet e përdorura bënë të kundërtën e asaj që ishte provuar si funksionale në vende të tjera. Estonia, veçse, të themi si ilustrim, që në vitin 1997, pajisi fillimisht familjet me kompjuterë; krijoi qendrat e mirëmbajtjes dhe ndihmoi përdorimin e Internetit nga mbarë shoqëria. Estonia, e integruar prej kohësh në Europë, përpara se të dërgonte kompjuterët nëpër shkollat, krijoi bazën e duhur që ndihmoi zbatimin e politikës së re. Sa i takon politikës që zbatoi qeveria jonë për E-nxënien, vendin e argumentit profesional e zuri babëzia për fitim të paligjshëm dhe diletantizmi. Sipas kontratës me vlerën 10 milionë dollarë, firmat serbe "MpSoft Grup" dhe "CT Computers", duhej të siguronin 10 mijë kompjuterë, printerë, skanerë etj., për laboratorët e 665 shkollave. Sakaq, u dorëzuan 46 laboratorë më pak nga vlera e kontraktuar; pa përmendur një numër të konsiderueshëm aksesorësh si kufje, karta kompjuteri etj. Nga ana tjetër, u shpërfytyrua trajnimi i mësuesve për përdorimin e TIK, proces ky që u mbulua nga propaganda. Rezultati: Pas mburrjeve për E-shkollat, më vitin 2012, UNICEF konstatonte se rreth 80% e fëmijëve të mostrës në studim nuk e njihnin Internetin.

Nisur nga një gjendje e tillë, ish-ministria teknike mund të përmendte projektin për digitalizimin e shkollave nëpërmjet integritit të TIK-ut në arsimin e mesëm, si një nga përpjekjet për të përballur sfidat e mëdha. Fillimisht, 60 shkolla të mesme të përgjithshme u bënë pjesë e projektit të digitalizimit të nxënies me tableta. Përmasë tjetër po krijohet një raport i ri mësues-nxënës, të

cilët ndërveprojnë nëpërmjet teknologjisë me njëri-tjetrin me mjetet që kanë në duar. Ndërkaq, ministria teknike mund të dijë për marrëveshjet me partnerë ndërkomëtarë që ofrojnë asistencën e tyre, si për bursa, ashtu dhe për kualifikimin e stafit pedagogjik, si Intel, Google, Microsoft, Samsung etj.

Si ish ministre, atë do duhet ta kishin informuar, gjithashtu, për zhvillimin e kurrikulës dixhitale (me teksat tekste shkollore dixhitale). Këto të fundit, mund të përkufizohen si tekste bazë për nxëniesit dhe studentët, me të cilat mund të nxënë përmbajtjet e përshtrutura për aftësitë dhe interesat e tyre. Përmasë teksteve dixhitale, nxëniesit mund të krijojnë tekste të tyre, duke nënvizuar pjesët e rëndësishme, duke marrë shënime dhe, së fundmi, duke kombinuar përmbajtjet që ofrojnë burimet e informacionit dixhital, me njohuritë cilësore dhe kompetencat e ndërtuara tashmë prej tyre. Zhvendosja nga tekste shkollore tradicionale te tekste digjitale do t'i lejojë subjektet të zëvendësojnë gradualisht tekste të tyre të rënda dhe të eksplorojnë botën përtëj mureve të klases.

D. Financimi për arsimin është ulur. Edhe ky është një pohim i pasaktë që reflekton padije të plotë. Fillimisht, ish ministria teknike nuk ka të qartë se, pas vitit 2013, shifrat që paraqesin financimin e APU-së nuk përfshijnë financimin e arsimit profesional. Nga ana tjetër, totali i fondeve buxhetore të miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), në programin buxhetor aftësimor, për vitin 2018, arrin shifrin e 38 miliardë e 374 milion lekëve, i përafërt me financimin e APU-së dhe atij profesional së bashku, në vitin 2013. Buxheti i MASR-it për vitin 2018, krahasuar me planin fillestar të vitit 2017, është rritur dukshëm, me 3.6 miliardë lekë ose 10,52% më shumë sesa viti që po lëmë pas. Për ta plotësuar tablonë, po shtojmë se rritja në APU reflektohet konkretisht në rritjen e shpenzimeve korrente, që janë shtuar me 2.040 miliardë lekë ose me 5.6%. Shpenzimet kapitale / investimet janë shtuar në total me 1.2 miliardë lekë më shumë se buxheti i rishikuar 2017 ose 48% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Nga sa parashtroam, shpresojmë që ish ministria teknike të bindet për nevojën e horizonteve të reja që mund ta ndihmojnë të gjejë shtegun për të ecur përpara. "Duke e pasqyruara këtë në mendjen tonë - thotë filozofi gjerman Gadamer - në kuptojmë ngushtësinë e horizontit, por dhe nevojën për zgjerimin tij, ose hapjen e horizonteve të reja". Kjo mund ta zhvendosë kontributin e kujtdo nga dëshirë e ligjshme, retorikë politike apo predikim vetjak, në investim efikas që u shërben specialistëve, mësuesve dhe shkollave.

Tiranë, më 16/11/2017



Opinioni **i** Ditës

# Panairi i përkthimeve dhe disa probleme me letërsinë kombëtare

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

...takohem me Tolstoin, Kazan-zaqisun, Çehovin, Dostojevskin, Hygonë, Stendalin, Dikensin, Andricin, Ricosin, Lorkën, Markesin, Murakamin etj., etj...

Përshtypjet e para të këtij panairi të ri janë disi të veçanta. Pasi kalon si në një paradë midis standeve me libra të përkthyer, mendon se nuk je në një panair shqiptar, as në Shqipëri. Je në panairin e librit të Parisit, të Frankfurtit, të Gjenevës, të Bolonjës, veç në Tiranë nuk mund të jesh... OK. Këtë drejtim i kanë dhënë botuesit e shumtë këtij panairi, nisur edhe nga përfitim i shpejtë. Është e vërtetë. Libri është në krizë. Dhe shtëpitë botuese janë në krizë, për shkak të shitjes së ngadalë të librit, por edhe për shkak të rënies graduale të lexuesit.

Le të mos keqkuptohemi. Këtë panair edhe pse e quaj "Panairi i përkthimeve", nuk mund t'ua ul vlerat përkthyesive dhe botuese. Përkundrazi. Duke shtëtur rreth standeve kam ndër një krenari të veçantë për punën, guximin dhe iniciativën aventurose që këta botues kanë ndërmarrë, për të sjellë në gjuhën shqipe gjithë këtë thesar të madh e të paqmar të letërsisë dhe filozofisë botërore.

Problemi që kam unë qëndron tek raporti që duhet të kishte midis letërsisë së autorëve të huaj me letërsinë shqiptare. Çdo nacionalitet synon stimulimin dhe reklamimin e vlerave kombëtare. Këtë gjë e kam parë vetë, me sytë e mi në panairin e librit të Gjenevës, të Bolonjës, të Frankfurtit, të Parisit etj. Në këtë panair autorët shqiptarë ndjehen si të huaj e të papërfillur. Një detyrë e tillë i takon Ministrisë së Kulturës, e cila edhe për shkak se vetë ministria është një përkthyes, është kthyer në një institucion të shoqërisë "tradukti", ndërkohë që duhet të ndodhte e kundërta.

Në tre lexuesit e mundshëm të librit shqiptar, që do të klasifikojë unë, lexuesi I "i munguar" është ai që ka emigruar, lexuesi i paktë, "i lodhuri" është ai që frekuenton çdo vit panairin dhe investon librat e mirë, ndërsa lexuesi i tretë, "i distancuar" është një lexues i ri, me i-Phon në xhep, ose i ulur para televizorit. Lufta me librin duhet të qohet lufta për afrimin e të tre llojeve të lexuesve shqiptarë. Lidhur me këtë panair të ri them me bindje se botuesit e kanë gjetur shpëtimin tek letërsia e përkthyer, e cila në të shumtën e rasteve botohet pa të drejtat e autorëve, shtu këtu edhe faktin që përkthimet nuk bëhen nga përkthyes profesionistë. Provo të hapë faqet e para të librave të përkthyer dhe do të ndeshesh me emra krejtësisht të panjohur.

Ka një vërshim të madh përkthyesish diletantë, të cilët pagu-



hen dobët nga shtëpitë botuese, ndërkohë që shumë përkthyes të mirë i gjen brenda dhe jashtë vendit. Bumi i emigracionit ka bërë që në fushën e përkthimeve të gjej përkthyes ekselente, por ata duhen kërkuar, duhen gjetur dhe duhen paguar sipas standardeve bashkëkohore të përkthimeve, të cilat janë të sanksionuara me ligj... Duke vizituar këtë panair të njëzetë mendoj se raporti letërsi shqiptare - letërsi e huaj është tejet në favor të letërsisë së huaj. Dhe kur sheh librin e një autori shqiptar, dijeni mirë se pagesa e librit shqiptar është bërë prej vetë autorit. Shtëpia botuese vetëm se i ka dhënë mundësinë e ISBN-së. Unë nuk jam kundër përkthimeve, madje në këtë panair gjen vepra të autorëve shumë të njohur. Mirëpo, ta mbushësh një panair me përkthime do të thotë të synosh "kolonizimin kulturor të një kombi me traditë të mëdha kulturore". Pas 45 vjet izolacioni kulturor, ne kemi pasur një uri të madhe për librin e huaj, por tashmë konstatojmë qetësisht se kjo uri jo vetëm ka kaluar, por është kthyer në të keqen e vet. Lexuesi shqiptar është velur me letërsinë e huaj, ai nuk gjen problemet e vendit të vet, nuk gjen karaktere dhe përshkrime të vendit të vet. Nga ana tjetër, edhe kjo letërsi e përkthyer i ka çmimet të kripura. Dominon shifra 5 euro dhe 7 euro, për të mos thënë që disa nga librat që kërkojnë nga lexuesi çmimet variojnë nga 1000-1500 lekë të reja. Librin për fëmijë "Hari Potter" 7, të cilin do ta blej për nipin tim, Neon, kushton 1400 lekë të reja. C'është e vërteta, midis morisë së përkthimeve të një letërsie lironadë, gjen edhe libra të rëndësishëm. Gjen romane nobelistësh, romane klasikë, libra filozofikë, letërsi për fëmijë etj., të cilat unë do të kisha dëshirë t'i kisha në bibliotekën time, por xhepi i një pensionisti, i një studenti, i një nxënësi, apo i një punonjësi nuk mund t'u përgjigjet çmimeve të botueseve. Unë i di mirë kostot e librave. Po të mendosh për një tirazh mesatar 500 kopje, gjë e pranueshme edhe për një shtëpi botuese pariziane, them me bindje se disa nga botuesit

e këtij panairi e kërkojnë fitimin mbi 50%.

"Panairi i përkthimeve" ka një histori të vet disavjeçare, por kohët e fundit ka ardhur duke u konsoliduar dhe përqendruar si një "panair i përkthimeve". Ajo duhet t'i vijë në ndihmë librit shqiptar me anë të subvencionit të autorit vendës, ku bëj pjesë dhe unë dhe që nuk kam parë ende asnjë dritë jeshile. Një vend nuk mbahet dot me mall të huaj. Si çdo prohim tjetër, edhe krijimtaria letrare është një prodhimtari intelektual, që kërkon ndihmën e shtetit.

Megjithatë, kur viziton këtë panair ndjen kënaqësi të veçantë, pasi vëren që është bërë një investim kolosal dhe me vështirësi të shumta për të arritur në një kohë të shkurtër këtë mal me libra autorësh, vendës dhe të huaj. Një kënaqësi tjetër e këtij panairi është kur sheh sesi disa shtëpi botuese kanë krijuar profilizime. "Toena" me librin tradicional, "Dituria" me shumanësinë e llojeve, "Onufri" me botimin e plotë të Kadare, "Uegeni" dhe "Eriku" me botimet e disa autorëve shqiptarë, "Skënderbeg book" me botimin e disa nobelistëve, "Omska" me kopertinat cilësore dhe botimin e autorëve të rëndësishëm botërorë. "Uegeni" me letërsinë ruse: Çehov, Dostojevsk, Stendal etj., "Noli" me Niçen etj. Do të ishte mirë që shembulli i Sh.b. "Onufri" me botimin e plotë të Kadare të ndiqej nga botuesit. "Toena" këtë gjë e ka bërë me F.Kongolin, Z.Çelën, N. Lerën dhe D.Çulin. "Konica" e ka bërë me Konicën, "Erik" e ka bërë me Zeqon. Një shtëpi tjetër e ka bërë me krijimtarinë e Petro Markos. Mendoj se ka hapësirë edhe për më shumë autorë të tjerë, të cilët këta botues duhet t'i bëjnë të njohur. Personalisht do të doja reklamimin e disa autorëve që unë i vlerësoj shumë, si F.Halitin, M.Vyshkën, F.Reshpen, H.Mecen, K.Petritin, B.Blushin, R.Gjozën etj. Në këtë panair marrin pjesë dhe disa shtëpi botuese kosovare dhe shqiptaro-maqedonas. Kjo gjë ia shton vlerat panairit, duke i dhënë një dimension mbarëkombëtar, mirëpo janë të rralla ato raste që një sh-

krimtar kosovar ose maqedonas të botohet i plotë nga një shtëpi botuese shqiptare, ndërkohë që botuesit e trevave shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë në këtë panair kanë sjellë botimet e disa autorëve shqiptarë. Te ky panair të bie në sy se si një autor shqiptar si R.Gjoza e gjen te stenda e shtëpisë botuese "Buzuku" me disa botime, ndërkohë që tek asnjë shtëpi botuese shqiptare nuk gjen veprat e një autori kosovar. Jemi të gjithë dëshmitarë se si priten autorët vendës nga shtëpitë botuese. Janë raste të rralla ato kur një botues merr përsipër botimin e një veprë letrare me shpenzimet e veta.

E theksoj sërish, dhe në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm duhet të lozhte Ministria e Kulturës. Me sa jam në dijeni, kjo ministri ka afruar një lloj klani të ashtuquajtur shkrimtarë. Është ai klan që përfiton nga kjo ministri dhe kur gjykon për përkthimin e librave.

Sa u përket shtëpive botuese, unë mendoj se ato kanë vështirësi të veta. Së pari, pasi u është larguar lexuesi tradicional. Së dyti, pasi libri ndryshe nga çdo produkt tjetër që del në treg, është një produkt me shije të ngadalë. Librit nuk ia merr dot fitimin brenda një viti. Së treti, libri ka funksion edukativ. Për këtë arsye, mendoj që Ministrisë së Kulturës sërish i del si detyrë ta ndjekë në vazhdimësi krijimtarinë e autorëve shqiptarë, edhe përmes studimeve, por edhe të subvencionojë disa nga autorët shqiptarë, përmes shtëpive botuese. Një punë lavdëruese ka bërë shtëpia botuese "Toena" dhe jo vetëm, e cila ka botuar shumë shkrimtarë shqiptarë me fondet e veta, madje ka botuar dy kolana cilësore, atë të poezisë dhe të tregimit. Në shembullin e kësaj shtëpie botuese duhet të ecni dhe të tjerë shtëpi botuese, në qoftë se e kuptojnë drejt misionin e vet. Është fjala për shkrimtarë të talentuar, të cilët i kemi të paktë si uranumi dhe duhet t'i konsiderojmë vlerë kombëtare. Ndryshe, çfarë kuptimi do të kishte kultura e një vendi kur ajo nuk sponsorizon talentet e veçanta në letërsi dhe muzikë, në pikturë dhe në artet tjera. Shqipëria, e kam thënë dhe një herë tjetër, nuk ka pasur dhe nuk ka vetëm një shkrimtar. Ka edhe disa të tjerë si Kadare, për të cilët duhet të investohet siç është bërë dikur për Kadarenë, të cilin u përkthyen romanet falas dhe vetë shteti bëri lidhje me shtëpi botuese të njohura në botë.

Më vjen mirë që kohët e fundit, në zërat e krijuara për biznesin dhe investimet, ka dhe një zë të rëndësishëm, i cili quhet "investimi për talentet". Së fundi, unë do t'u lutësua përzemërsisht botuesve dhe ministrive që të mendojnë pak edhe për ligjin e sponsorizimit e cili ende nuk kuptohet drejt se çfarë humbet dhe çfarë fiton shteti dhe biznesmenët nga ky ligj.

## HOROSKOPI

### DASHI

Pozicionimi i Hënës në lidhje me Venusin dhe Marsin parashikohen shtabi, por rezultati varet nga si do të dini të menaxhoni çështjet më delikate që lidhen me dy persona. Të merrni pak kohë pushim për të menduar mund të jetë gjeja e drejtë për të bërë, por nuk do të ishte valle një mënyrë për t'u larguar datyruara.

### DEMI

Interesa të përbashkëta mund të jenë edhe baza solide për në lidhje të bukur. E gjitha qëndron në faktin që të mos përfshihen nga frika instinktive. Kini me shumë besim tek personi i dashur, edhe pse mund të ketë nevojë për pak forcmir nga ana e juaj.

### BINJAKET

Nuk ka asgjë të keqe nëse doni të qëndroni të vetëm, edhe pse në një këndvështrim afatgjatë, vetmia nuk do t'ju bënte fare mirë. Përzijuni të hyni në lojë. Duke qenë aktivë, do të përjetoni me shumë çaste të mbushura me emocione.

### GAFORJA

Nuk është kurrë e tepërt të tregosh kujdes, por me pozicionimin e Hënës në lidhje me Saturnin, ekziston rreziku që të mos lëvizni, pasi mund t'ju frikësojë çfarë mund të ndodhë. Jupiteri ju mban shpallullat e ngrohta, ndërsa Marsi dhe Venusi ju kundërshtojnë. Me të vërtetë është një betejë e vështirë për ju.

### LUANI

Përpara se të bësh bilancin e humbjeve, mendoni mbi të gjitha të merrni veten pa pasur pendime dhe paragjykimë, që nuk i bëjnë kurrë mirë një marrëdhënieje. Mund të bëni edhe më shumë, por ndoshta problemi është se nuk doni që të vazhdojë historia.

### VIRGJERESHA

Pak fat nuk bën keq, mbi të gjitha të kur lëvizni mbi terren të vështirë për çështje të ndryshme, të cilat mund të mos japin rezultat in e duhur. Një dorë ju zgjatet t'ju ndihmojë nga një drejtim i papritur. Një frymë-marrje letësimi.

### PESHORJA

Së shpejti do të arrini të gjeni një ekuilibër, por për momentin duhet të kënaqeni, të ecni me kujdes, duke shënjestruar mirë. Merrni përsipër angazhimet tuaja, pa e hedhur diku tjetër fajin.

### AKREPI

I vetmi defekt i juaj i vërtetë mund të jetë gjendja e lëvizshme emocionale, por me sa duket në disa raste duhet të kapësh momentin dhe të mos presësh! Preten-dentit janë të shumtë dhe koha në dispozicion mund të mbarojë. Vendosni pa humbur kohë!

### SHIGJETARI

Të pavëmendshëm ndaj kritikave, përpiqueni t'i përfundoni çështjet që lidhen me administrimin e zakonshëm. Për pjesën tjetër do të mendoni në një çast të dytë. Në fund e vërteta del gjithmonë në shesh dhe do të fitoni lavdërimin pa fund.

### BRICJAPI

Nuk do të ishte keq të ishit më të pavarur dhe jo të nënshtuar ndaj kontrollit të një eprori. Tani, megjithatë, të provosh një lëvizje do të ishte e rrezikshme. Shtrëngoni dhembët dhe buzëqeshni, edhe pse, në të kundërt, do të donit të shprehnit mosmiratim.

### UJORI

Të shfaqeni i freskët dhe të ripërtërirë pas një mbledhjeje të gjatë dhe të lodhshme nuk është e lehtë. Por ju, të fuqishëm nga energjia juaj e pashterueshme, do t'ia dini edhe pas kësaj. Mos u shqetësoni shumë nga opinioni i të tjerëve dhe vazhdoni të ecni përpara në rrugën tuaj.

### PESHQIT

Me pozicionimin e Hënës në lidhje me Uranin, ambicia nuk do t'ju mungojë dhe do të jeni të notur të përfundoni me sukses projekte madhështive dhe interesante. Kushdo që do të fusë hundët midis jush dhe dëshirave tuaja do të humbasë kohë, duke mos pasur asnjë shans për t'ju ndëlar.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT



Trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja ka mbetur i kënaqur nga barazimi ndaj Flamurtarit. Strategu i korçarëve kritikoi disa prej futbollistëve të tij, të cilët sipas tij zhvilluan një pjesë të parë shumë të dobët. "Barazimi ishte rezultati më i drejtë, pasi e nisëm jo mirë pjesën e parë. Patëm edhe ne mungesat tona, por arritëm që të vendosim në vështirësi kundërshtarin në ato ras-

Daja nuk e bën dramë, por ka pakënaqësi për lojtarët

te që na u dhanë. Jam i kënaqur nga pjesa e dytë, por nuk jam i kënaqur nga pjesa e parë, ku disa lojtarë që patën mundësi për të luajtur shpenzuan shumë energji të kota. Kampionati është i gjatë, por po

mbajtëm këtë ritëm që kemi treguar deri më tani jemi në rrugën e duhur. Skuadra ka treguar mentalitetin e duhur në fushë, edhe pse nuk duhet të gabojë në këtë mënyrë si në 45 minutat e para. Soue? Ku një lojtar

vjen nga avioni dhe ka luajtur me kombëtaren e tij, ai e ka ritmin e lojës. I vetmi problem në këtë rast mbetet ngarkesa që kishte në këmbët e tij. Ai është një lojtar në ritëm, pasi ka qenë në aktivitet. Sot nuk kishte dita e duhur për të luajtur ndeshje, pasi të kesh katër lojtarë me kombëtaret dhe të luash pas dy ditësh, kjo e bën të vështirë", tha Daja pas ndeshjes.

Shënojnë të parët vlonjatët me Bicajn, korçarët përgjigjen me Muzakën në minutën e 88-të

# Skënderbeu merr një pikë mes polemikash në Vlorë

Flamurtari kërkon një 11-metërsh, i anulohet një gol



Jeton Selimi

Flamurtari ndal Skënderbeun në një takim të nxehtë të luajtur në Vlorë, por që në fund është mbyllur me rezultatin e barabartë 1-1. Vlonjatët kërkonin të thyenin Skënderbeun pas një jave të mbushur me polemika dhe akuzat për favorizime drejtuar korçarëve dhe federatës, ndërsa në shkallët e stadiumit atmosfera ishte e ndezur. Dhe si për t'i hedhur benzinë zjarrit në minutën e 23-të kemi një moment të dyshimtë në zonë, ku Juxhin Xhaja nuk vërshtëllën një penallti në favor të vendësve pas ndërhyrjes të Micit ndaj Xhufos. Megjithatë, Flamurtari do ta gjejë golin e epërsisë në minutën e 38-të me Ditmar Bicajn, që mbi vijë fatale shtyn në portë topin e gjuajtur nga Sidibe. Skënderbeu do të reagojë edhe në minutën e 52-të, por Takun e ndal një Nurkovic i shkëlqyer. Në minutën e 82-të Flamurtari do të shënojë golin e dytë me anë të Bushiq, por kryesori Xhaja do anulohet pas sinjalizimit të anësorit për ndërhyrje të gabuar ndaj portierit Shehi. Një tjetër rast i dyshimtë, ky në dëm të

SUPERLIGA	
JAVA E 10	
<b>TË MËRKURËN</b>	
Lufëtari - Teuta	2-3
Vllaznia - Lushnja E shtyrë	
<b>TË ENJTEN</b>	
Laçi - Partizani	1-0
Kamza - Kukësi	2-2
Flamurtari - Skënderbeu	1-1




DURO

Trajneri i Flamurtarit, Shpëtim Duro, ka deklaruar se ekipi i tij meriton më shumë dhe se gjyqtarët kanë qenë pengesa e vetme, me i saktë në të 92'-ën. Gjithsesi, mbyllet 1-1 në Vlorë, me Skënderbeun që ruan të njëjtën distancë largësie me Kukësin dhe Flamurtarin.

të merreshin penallti nga skuadra e tij këtë sezon. "Komplimente skuadrës për çfarë ka dhënë se kishim përballë një ekip si Skënderbeu. Skuadra ka bërë detyrën gjatë gjithë lojës, përballë kishim një skuadër që dihet forca. Por sot e meritonim paqetë fitoren, kemi shënuar, kontrolluar, kemi mbyl-

lur hapësirat e kundërshtarit. Kam rezerva për gjykimin, nëse goli i dytë ishte i rregullt, kam mendimin që e kemi fituar takimin. As nuk diskutohet që është gol i rregullt. Është hera e dytë, edhe me Kukësin, edhe këtu. Penalltia? Nuk e di nëse ka qenë, nuk e di a do të kemi marrë ndonjëherë penallti dhe nuk besoj të marrim deri në fund të kampionatit. Çfarë të bëjë skuadrat më shumë, nuk e kuptoj. Me Kukësin nuk jep penallti, anulon gol të rregullt, sot (dje) prapë. Çfarë t'i kërkoj skuadrës? Shihet që skuadra ka luajtur shumë mirë në dy ndeshjet e fundit, duhej të merrnim më shumë. Nëse gjykimet do të ishin më të rregullta, do të kishim marrë më shumë. Jam i kënaqur, por i zhgënjyer për futbollistët dhe tifozët, se nuk është zgjedhje e mirë kjo e gjykimet".

JUSTIFIKIMI I TRAJNERIT



Starova: Skuadra nuk ka qetësi dhe ka frikë nga rezultati

Trajneri i Partizanit, Sulejman Starova, mendon se shkaqet e humbjes në Laç janë ato që lidhen me gjendjen psikologjike të skuadrës dhe situatës që ka kaluar ajo deri tani. Mes të tjerash, për "Supersport" ai theksoi: "Ishte një pjesë e parë e pëlqyeshme, por më pas u vështirësua gjithçka. Terreni, era, na penguan të bënim lojë tonë. Mora përgjigje pozitive, por pësuan një gol nga një gabim foshnjarak. Kjo është e pafalshme. Nervozizmi i Bathës buron nga e kaluara. Nuk ka mundësi që një skuadër të bëjë kaq shumë gabime teknike. Do të luftojmë për të dalë nga gjendja. Është fakt që jemi në krizë, por forcën duhet të gjejmë brenda nesh. Partizani ka reaguar kur pëson gol, por sot (dje) nuk e bëri një gjë të tillë. Pjesa më e madhe nuk ka dhanë maksimumin në pjesën e dytë. Sulmi? I kemi përveshur mëngët për të përmirësuar gjërat negative. Ka shumë gjëra dhe është më e vështirë për ne. Duhet të tregojmë lojtarët më tepër kujdes për të shënuar të paktën golin e barazimit. Vjet ishim skuadra më e mirë dhe dua rendimentin e atyre lojtarëve që ishin edhe sezonin e kaluar. Kam bërë ndryshimet e mia dhe ky ishte mendimi i stafit dhe lojtarëve për ta nisur kështu. Nuk flas për fajin tim, por po bëjmë një analizë të skuadrës, pasi prisja shumë prej saj. Pëson gol dhe nuk reagon për 20 minuta... Ka mungesë qetësie dhe frikë nga rezultati".

Të kuqtë e kryeqytetit nuk gjejnë shërim as te Starova

Partizani prek fundin në Laç, super Plaku ndal Kukësin



që e kishte të pamundur të bënte qendërsulmuesin. Vendosi gjithçka një gol i sulmuesit nga Mozambiku, Reginaldo në fillimin e pjesës së dytë me këtë të fundit, që i shërbyer nga Uzuni, mposhti Alban Hoxhën. Me


këtë fitore Laçi u ngjiti në kuotën e 14 pikëve dhe la pikërisht pas Partizanin në renditje me vetëm 11 pikë. Në Kamëz vendësit ndalën edhe Kukësin në një barazim 2-2, duke vendosur në pikëpyetje të madhe të ardh-

men e trajnerit serb, Mladen Milinkovic, në krye të kampionëve të Shqipërisë. Një Sebino Plaku në superformë autori i një dygolëshi nuk i mjaftoi Kamzës me skuadrën e Ndreut, që duhej të kënaqej me vetëm një pikë edhe për shkak të pasigurisë që shfaqti mes shtyllave Argent Halilaj. I dyshimtë goli i avantazhit provizor të Kukësit, i shënuar nga braziliani Elton Cale, i cili në momentin e finalizimit u përplas me Halilajn duke e dëmtuar portierin e Kamzës. Megjithatë, skuadra nga periferia e kryeqytetit

nuk u dorëzua dhe pasi kishte humbur disa raste të pastra në minutat e para, gjeti barazimin me një supergol të Sebino Plakut, i cili në të 41'-tën shënoi me një goditje të bukur nga distanca. Në të 55'-n vendësit gjetën edhe epërsinë me Plakun, që këtë herë goditi saktë edhe me kokë pas një krosimi të Frashërit. Gjithsesi, Kukësi arriti të dilte me një pikë nga kjo transfertë e vështirë, pasi në të 76'-n Rrumbullaku me një goditje të fortë nga rreth 40 metra barazoi shifrat në 2-2, i ndihmuar edhe nga Halilaj, që u shfaq disa i pasigurt në ndërhyrjen e tij. Me këtë barazim Kukësi ruan vendin e 2-të tashmë në kuotën e 19 pikëve, ndërsa Kamza pozicionohet e 4-ta në kuotën e 16 pikëve.



**Fjalëkryqi (1)**




**HORIZONTAL**

- Salacrou dramaturg
- Blair e Ekzorcist.
- I bylbylit ai i Mjedës.
- Inicialet e Morricones
- Gjysmë vektor.
- Një port përballë Xhibutit.
- Në mes të Salt dhe City.
- Janë stacionet e beduinëve.
- Një pjesë e taktikës.
- Janë tifozë partie.
- Janë firmat mashtruese.
- Përpunojnë naftë.
- Janë konservatorë.
- Është derri.
- Një monedhë maqedonase.
- Kufizojnë ambiente.
- Inicialet e Gould aktor.
- Fillojnë jetën.
- Janë dëshmorët.

**VERTIKAL**

- Film i James Cameron.
- Jeronim de i Milosaos.
- Është doktori me bluzë të bardhë.
- Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
- Janë si jerm.
- Fillojnë lejen.
- Klikohet me mouse
- Një vegël.
- Luftohet me kinina.
- Janë cilësi.
- Janë reaksionet në epurvea
- Një sportist që kërcen me shkop.
- Janë tek në zhele
- Është kullë xhamie.
- Bëhet një për zakon.
- Gruaja e Fantozzi-t
- Gjysmë afërsi.
- Janë ndriçues.
- Nuk duhet shkelur një i tillë.
- U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
- Një fjalë për gjoja.
- Garbo e kinemasë.
- Braktisi Didonën.
- Me të bëjnë një thikë.
- Mund të jetë gjaku.
- Janë dhoma.
- Ai dhe ajo.
- Ushtria republikane irlandeze.
- Agjenci Transporti Korçë.
- Me stpon në box.
- Inicialet e Moravia-s.

**Fjalëkryqi (2)**




**HORIZONTAL**

- Ishte babai i parë.
- Indërmarri progresistët.
- Thyhet një me kohën më të mirë.
- U braktis nga Helena.
- Seritë pa zë.
- Kryeqyteti i Kinës.
- Ramazzotti këngëtar.
- Është sport me vozitje.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Janë shërre në shtyp.
- Inicialet e Clapton.
- Është shuma e brinjëve të drejtëkëndshit.
- Një letrar është tregimi.
- Fillojnë nazet.
- Matet pa kufij.
- Inicialet e Kokoschka piktor
- Kufiojnë mendimet.
- Bergman që qe aktore.
- Është shpërblimi në para.
- Është i keq.


**VERTIKAL**

- Venger trainer.
- Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
- Një është edhe Bujar Lako
- Fillojnë mobilizimin.
- Institucione Rajonale Polake.
- Një rapper i famshëm.
- Kështu thirrej Ronaldo, bomberi brazilian
- Ndëzr në aparaturë.
- Një film i ribërë.
- Ekstre me model.
- Dy asa.
- Është fytyra kamionit.
- Mund të bëhet me medalje trimërie.
- Mund të jenë të rastit.
- E ka simbolin Ti.
- Është dëm, qeder.
- Inicialet e Tappert.
- Një pjesë e pejsazhit.
- Ndahet në barazim.
- Janë kandilë deti
- Hayëorth që qe aktore
- Është enë për të skuqur.
- Emri i Zola.
- Gjysma e globit.
- Janë në skaje.
- Kryqyteti i Letonisë.
- Eva... Isabel Allende-s
- Një stacion i famshëm orbital
- Inicialet e Lennon.
- Difong në duet.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		6		8	5			1
7		3			6			4
		1		9				2 5
				7 4			2 1 8	
9								3
1 4 8				6 2				
4 8				3			5	
	6		2			7		4
3		5 7			9			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	8	9	1	3	5	2	7	4
4	5	3	7	8	2	6	9	1
7	2	1	4	9	6	8	5	3
8	4	6	2	7	3	9	1	5
1	3	5	9	4	8	7	6	2
2	9	7	5	6	1	3	4	8
5	6	4	3	2	9	1	8	7
9	1	2	8	5	7	4	3	6
3	7	8	6	1	4	5	2	9

*Argëtim filozofik*

- Shumica e shqetësimeve në botë shkaktohet nga njerëzit që duan të jenë të rëndësishëm. (T.S.Eliot)
- Kur heronjtë largohen nga skena, atëherë hyjnë kilounët. (Hajrii Hajne)
- Sa burra vërtetë të zotë janë më shumë se një herë në ditë? (Napoleon Bonaparti)
- Asnjëherë mos prishni atë që mund të zgjidhni. (Zhozef Zhuber)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

14	S	I	S	P	A	3	11	11	15	9	14	3
2	8	2	9	2	6	15	9	2		17	11	
6		5	5	8	2	6	8	2	8	2	14	
	11	4	12	2	7		6	2	11	2	3	
8	2	9	4	6	3		6	9	15	9	3	
9	5		3	2	12		2	4	7	3	2	14
4	6	2	6			4		6	3	14		17
8	5	13	19		4	9	3		3	15	6	
3	7		6	19	12	3		4	12		11	4
6	3	9	2	13	4	6		9	3	12	2	6
4	13		6	3	6	2	13	3	11	4		4
6	2	15			4	9		11	15	9	2	6

S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A	
H	E	R	O	I	N	A	O	V	E	R	
S	A	S	S	N	R	V	R	T			
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	
M	I	N	E	R	A	L	E	T	C		
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V
C	A	R	I	S	T	I	N	T	L		
V	H	I	M	I	M	I	K	E			
R	A	M		E	T	N	A	R	R		
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T

*Thënie të mençura*

- Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë.. Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI.
- Tre janë metodat nga marrim dije: e para, nga reflektimi që është më fisnikja; e dyta, nga imitimi që është më e thjeshta dhe e treta nga eksperiencia, që është më e hidhura. (Konfuci)
- Sokrati: Lumturia është dhunti e natyrshe, mjerimin e shkaktojnë mungesat artificiale.
- Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njeri i dëshur. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	T	A	H	E	L	M	E	T			
A	R	R	V	E	D	E	P	P	P			
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	O	L	I	F	E	M	I	O	L	E		
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	E	T	I	K
L	A	I	R	A	E	R	R	E	Z	E		
E	R	A	I	B	E	M	R	I	I	S		
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E		
T	A	L	E	N	T	E	T	A	T	R	E	
E	K	R	A	H	O	R	A	R	I	A		
S	I	P	R	I	T	A	T	R	E			
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A
D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P	
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A		
E	N	T	G	N	I	R	H	R				
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A	A	
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I	D	E
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H		
K	E	N	I	T	T	K	A	S	H	E	T	
E	M	I	L	E	N	J	O	M	E	R		
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T	I	
A	K	S	E	R	I	O	Z	N	A	M		
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

